



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:  
Financë  
Kolegji Universitar “Qiriazi”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Rinaldo Muça**

**Prof. As. Dr. Brikena Leka**

**Qershor/ 2024**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT****Bachelor në "Financë"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar 'Qiriazi'
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në 'Financë'
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 290, datë 17.09.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendimi Nr.208, datë 03.07.2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 32 studentë 2021-2022 25 studentë 2022-2023 27 studentë
19	Komente / të tjera:	-

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Kolegji Universitar "Qiriazhi" është IAL jopublike që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit të lartë në RSH, në përputhje me parashikimet e Ligjit 80/2015 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Aktiviteti i Kolegjit ka nisur në vitin akademik 2006-2007, përmes VKM nr. 274, datë 10.05.2006. Vendndodhja e Kolegjit është në Kodër Kamëz, Tiranë, pranë Universitetit Bujqësor.

Programi i studimit nën shqyrtim për akreditim, ofrohet nga Departamenti i Financës, njësi bazë kjo në përbërje të njësisë kryesore, Fakultetit Ekonomik në këtë Kolegj. Ky program ofrohej fillimisht nën emërtimin "Drejtues Finance", në përputhje me VKM-në e sipërcituar të licensimit dhe më pas, në bazë të Urdhërit nr. 208, dt. 03.07.2020, ndryshuar me Urdhërin nr. 209, dt. 17.09.2020, u riorganizua në program Bachelor me titullin "Financë".

Programi është i organizuar në 6 semestra, të vlerësuar sipas sistemit ECTS me total kreditesh 180. Ai është i ndarë në lëndë e module, në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019. Programi i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit dhe ofrohet në gjuhën shqipe. Kodifikimi është bërë me numrin 63BA0412S, në përputhje me udhëzimet e dhëna në VKM nr. 310, dt. 11.15.2022 dhe Udhëzimin pasues nr. 31, dt. 15.11.2022.

Në ofrimin e programit, njësi bazë dhe ajo kryesore, duket se kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për ta lidhur atë me tregun e punës brenda vendit, njehsuar atë me praktikat e mira nga IAL vendase dhe të huaja, sikurse dhe ushqyer me feedback konkret për rritjen e mëtejshme të cilësisë.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit “Financë”, aplikuar nga Kolegji Universitar “Qiriazi”, u ngrit me Urdhërin nr. 106, dt. 01.08.2023, nga Drejtori i Përgjithshëm i ASCAL, në referencë të Ligjit 80/2015 dhe VKM-së nr. 109, dt. 15.02.2017. Në përbërje të grupit, si ekspertë u caktuan Dr. Rinaldo Muça dhe Prof. As. Dr. Brikona Gjoni Leka. Grupi i Vlerësimit të jashtëm u asistua nga Koordinatorja Teknike e ASCAL Znj, Rajna Lilaj. Në përputhje me agjendën, grupi i vlerësimit të jashtëm mori njoftim për procesin e akreditimit dhe u njoh me materialet e depozituara në platformën e-ASCAL.

Fillimisht, procesi vlerësues u krye mbi bazën e studimit arkivor, ku ekspertët studiuuan dokumentacionin e depozituar elektronikisht. Pas analizimit dhe krijimit të hartës së riskut, ekspertët dakordësuan për ndarjen paraprake të detyrave në gërmimin dhe testimin e informacionit të mëtejshëm për plotësimin e draft raportit, ku z. Muça u fokusua më së shumti në 3 rubrikat e para, ndërsa znj. Gjoni Leka në 3 të dytat. Për plotësimin e informacionit, ekspertët hartuan intervista me pyetje të hapura të cilat u adresuan në vizitën inspektuese 2-ditore në mjediset e KUQ. Gjatë kësaj vizite (dt. 12-13.10.2023), ekspertët u takuan me staf akademik, ndihmës akademik, administrativ, studentë, etj., për të kryqëzuar të dhënat e përmbajtura në dokumentet e depozituara paraprakisht, sikurse edhe për të sqaruar apo zgjeruar bazën e informacionit.

Feedback-u i subjektit nën akreditim, nga të gjitha palët pjesëmarrëse ishte pozitiv, bashkëpunues dhe efektiv. Kërkesës për depozitim të informacionit shtesë nga ana e grupit të vlerësimit të jashtëm, subjekti iu përgjigj menjëherë dhe cilësisht.

Pas vizitës inspektuese në terren, GVJ filloi punën për hartimin e draft-raportit, në përputhje me ndarjen fillestare të detyrave. Pas shkëmbimit dhe komenteve reciproke mes ekspertëve, sikurse edhe nën asistencën dhe observimin e koordinatorës së ASCAL, drafti mori formë përfundimtare.

Vlerësimi u krye duke iu përmbajtur formatit të parapërgatitur nga ASCAL, sikurse duke iu referuar burimeve të kritereve që janë përmendur në mënyrë eksplicite rast pas rasti. Në çdo rast është bërë krahasimi midis realitetit të konstatuar nga dokumenti, vizita apo prezenca online e subjektit, me normat ligjore, statutores, rregullative apo të tjera që përmbahen në aktet në fuqi dhe të vetë institucionit. Nga ky krahasim, janë nxjerrë konkluzionet përkatëse dhe më pas janë dhënë rekomandimet e mundshme për përmirësim. Në këtë kuptim, vlerësimi ka synuar të jetë më së shumti sistemik, për shkak edhe të formatit paraprak të kërkuar nga ASCAL.

GVJ është i vetëdijshëm se siguria që jep ky draft-raport për vijimin e procesit akreditues të këtij programi studimi në KUQ mbështetet kryesisht në bazën dokumentare dhe vizitën 2-ditore në subjekt, dimensione këto jo gjithnjë plotësisht të mjaftueshme për të vlerësuar performancën 4-vjeçare nga akreditimi i fundit i këtij programi, sikurse është rasti në fjalë.



Më datë 14.05.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 76/7 Prot., Datë 14.05.204, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 65 Prot, Datë 20.05.2024.

Komentet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, për Programin e Studimit Bachelor në "Financë".

**Mbi komentet e institucionit lidhur me Draft Raportin e Vlerësimit të programit të studimit Bachelor në "Financë" të Institucionit të Arsimit të Lartë KUO**

GVJ shqyrtoi komentet e bëra nga Institucioni lidhur me draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Më poshtë po rendisim sqarimet tona për komentet e bëra prej institucionit.

**Konkretisht:**

1. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e katërt, Standardi IV 1 kriteri 8, **nuk ka ndryshime në raport.**

*GVJ është shprehur se sugjeron vlerësimin me notë të studentit në praktikën mësimore, pasi njohuritë e përfituara të studentëve gjatë praktikës ndikojnë në ngritjen profesionale të tij, duke ndikuar në formimin e tij, gjë që duhet të reflektohet edhe në vlerësimin e përgjithshëm të studentit. Gjithashtu duke qenë se praktika profesionale në programin mësimor vlerësohet me një numër të konsiderueshëm kreditesh (8 ECTS), nënkupton që mesatarja e ponderuar e studentit deformohet, duke mos konsideruar këto kredite në numrin total të krediteve.*

GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, shpjegon që GVJ nuk ka konstatuar asnjë mospërputhje me kuadrin ligjor (referuar VKM 41, datë 24.01.2018), por sugjeron që praktika të vlerësohet me notë, duke konsideruar peshën që ka në formimin e studentit dhe në mesataren e tij.

**Nuk ka ndryshim** në vlerësimin për Standartin Përkatës. Sugjerimi i GVJ-së për këtë kriter nuk ka ndikuar në vlerësimin "Përmbushet kryesisht" për këtë standart.

2. Lidhur me komentin që bëhet për Fushën e katërt, Standardi IV 1 kriteri 6, **ka ndryshime në raport** në mënyrën si është shprehur fjalia.

*GVJ konstaton se Institucioni ka të nevojshme një sistemim më të mirë të dosjeve të personelit akademik, të përditësimit të dokumenteve, si dhe mbajtjen e tyre jo vetëm në formatin fizik, por edhe në formatin on-line, që informacioni të jetë si transparent, ashtu edhe lehtësisht i aksesueshëm.*



GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, shpjegon që mbajtja në formatin on-line është përdorur si term për versionin soft-copy të dosjeve të përditësuara të personelit akademik, jo që të dhënat e stafit akademik të jenë të aksesueshme on-line nga të gjithë. Komenti ndryshon në: GVJ konstaton se Institucioni ka të nevojshme një sistemim më të mirë të dosjeve të personelit akademik, të përditësimit të dokumenteve, si dhe mbajtjen e tyre jo vetëm në formatin fizik, por edhe në formatin soft copy, që informacioni të jetë si transparent, ashtu edhe lehtësisht i aksesueshëm.

**Nuk ka ndryshim në vlerësimin për Standartin Përkatës.**

3. Lidhur me komentit që bëhet për Fushën e katërt, Standardi IV.3 në rubrikën “Konkluzione”, **nuk ka ndryshime në raport.**

GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë të përditësuar në bibliotekë, veçanërisht për literaturën ndihmëse dhe për publikime shkencore; regjistrimin/ abonimin në biblioteka online ku studentët dhe stafi akademik të kenë akses. Kjo do të ndikojë në rritjen e cilësisë së këtij program studimi dhe të kërkimit shkencor të Institucionit.

GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, shpjegon pavarësisht se vlerëson investimet që ka bërë Institucioni për shtimin e literaturës fizike dhe atë online, por si në dokumentacionin shoqërues, dhe veçanërisht gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi mungesat e shprehura në Standartin IV.3.

**Nuk ka ndryshim në vlerësimin për Standartin Përkatës.**

4. Lidhur me komentit që bëhet për Fushën e katërt, Standardi IV.4, kriteri 1 në rubrikën “Konkluzione”, **ka ndryshime në raport.**

GVJ gjatë vizitës në sekretari evidentoi disa parregullsi:

- Mungesë të regjistrimit të diplomimit;
- Korrigjime me korrektor të numrit të matrikullimit të studentëve;
- Në disa raste në regjistër u evidentua mungesë e numrit të matrikullimit dhe evidentim me një kod tjetër, ndërkohë që në kompjuter ishin të hedhur numrat e matrikullimit edhe për këta studentë, njëjloj si për të tjerët;
- Mungesë hedhje note në regjistrin fizik, ndërkohë që nota ishte hedhur në procesverbal, dhe në regjistrin elektronik.

GVJ në përgjigje të komenteve të Institucionit, shpjegon se:

GVJ evidenton mungesë të regjistrimit të diplomimit, siç edhe Institucioni bie dakort. Meqënëse si gjatë vizitës në Institucion, si në komentet dhe materialet shoqëruese, u shpjegua që mungesa e regjistrimit të diplomimit, vjen si pasojë e mospajisjes së Institucionit me të prej QSHA-së (Qendra e Shërbimeve Arsimore), atëherë konstatimi i GVJ, po shoqërohet me shpjegimin përkatës:



- *Mungesë të regjistrit të diplomimit;* Insitucioni shpjegon se mungesa vjen si pasojë e mosdërgimit të këtij regjistri nga organizmi përgjegjës (QSHA).

Ndërkohë, përsa i përket gjetjeve të tjera, Institucioni bie dakort që qëndrojnë. GVJ mirëkupton korrektimet në regjistër për gabime njerëzore, apo faktin që stafi në sekretari është relativisht i ri, por duke konsideruar rolin dhe rëndësinë e kësaj zyre, mendon që Institucioni duhet të kishte treguar kujdes më të madh për performancën e Sekretarisë Mësimore ndër vite.

**Nuk ka ndryshim në vlerësimin për Standartin Përkatës.**

**Për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm:**

Dr. Rinaldo Muça

Prof. Asoc. Dr. Brika Leka

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Financë”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Financë”, ofruar nga KU ‘Qiriazi’ ka kaluar, që nga themelimi i tij në vitin 2009, në të gjitha filtrat ligjorë të parashikuar nga aktet ligjore, nënligjore e rregullative që aplikohen në Republikën e Shqipërisë, lidhur me arsimin e lartë. Statuti, rregulloret dhe aktet e tjera të vetë kolegjit janë në të njëjtën frymë dhe mbështesin e kontribuojnë në objektivat kombëtare të parashikuara për arsimin e lartë nga Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, paragrafi 6.3 “Qëllimi i Politikës C: Arsimi i Lartë”. Në statutin e kolegjit specifikohet konkretisht se: <i>“Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standardet dhe arrijtet më të mira ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato europiane në veçanti”</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ <i>Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, <a href="https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/">https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/</a></i></li><li>▪ <i>Ligji 80/2015 <a href="https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimit-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij/">https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimit-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij/</a></i></li><li>▪ <i>Aneks 1.1: Statuti KUQ</i></li></ul>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Rregullorja e programit të studimit, si dokumenti imediat mbi të cilin funksionon ai, është e mbështetur në statutin dhe rregulloren institucionale, sikurse edhe në rregulloren e njësisë themelore ku njësia bazë, ofruese e programit të studimit, është e akomoduar. Kjo rregullore zbërthen dhe detajon qëllimin e misionin institucional dhe, sëbashku me kurrikulën e programit, ofron një produkt të prekshëm akademik dhe administrativ për pedagogët dhe studentët e angazhuar në këtë program studimi.</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneksi 1.1: Statuti KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 1.2: Plani Strategjik KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 1.3: Rregullore KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 2.2: Plani Strategjik FE-KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 2.3: Rregullore FE-KUQ</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit reflekton frymën e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI 3 2022-2030), specifikisht paragrafin mbi <i>Kohezionin Social: Arsim Cilësor për të Gjithë</i>. Vetë SKZHI 3 ka huazuar nga Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, paragrafin 6.3 të cituar në Kriterin 1 më lart, paragraf të cilin ky program studimi e ka integruar dhe mbështetur me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij. Programi i studimit, sikurse cituar në kriteret më lart, ofrohet në përputhje me aktet rregullative të vetë institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, <a href="https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/">https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/</a></i></li> <li>▪ <i>Ligji 80/2015 <a href="https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij/">https://arsimi.gov.al/ligji-nr-80-2015-per-arsimin-e-larte-dhe-kerkimin-shkencor-ne-institucionet-e-arsimit-te-larte-ne-republiken-e-shqiperise-dhe-aktet-nenligjore-ne-zbatim-te-tij/</a></i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.1: Statuti KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 1.2: Plani Strategjik KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 1.3: Rregullore KUQ</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Kolegji 'Qiriazit' përpaket të vijojë traditën e një prej institucioneve arsimore më të vjetra në vend. Nën këtë frymë, drejtuesit aktualë të institucionit kanë angazhuar një sërë burimesh njerëzore (akademike, ndihmës-akademike dhe administrative) të cilët karakterizohen nga një eksperiencë e gjatë dhe e pasur në arsimin e lartë, në vend dhe jashtë tij, specifikisht për këtë program studimi. Nga pikëpamja e burimeve financiare, logjistike dhe pronësore të tjera, institucioni ofron optimalisht vlerat e duhura, në raport më numrin e studentëve të programit dhe objektivat e veta të rritjes. Nga pikëpamja e dokumentacionit dhe akteve rregullative që rregullojnë programin, mbështetja për realizimin akademik të tij është konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.</p>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.14 – Relacion mbi mjediset mësimore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.14.2 – Infrastruktura mësimore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.6 – Stafit akademik sipas departamenteve në FE</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.10 – Stafit akademik i njësisë bazë të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.11 – Stafit akademik i angazhuar në program</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.12 – CV-të e stafit të angazhuar në program</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.14.1 - Plani buxhetor 2018-2025</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.21(1-2) – Plani i financimit të programit</i></li> </ul>								
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Financë, pranë KU “Qiriazi”, ofrohet nga Departamenti i Financës, pjesë përbërëse e Fakultetit të Ekonomisë si njësi kryesore. Orientimi i fakultetit, vlerësuar nga këndvështrimi i profileve të diplomës që ofron, është përgjithësisht mikroekonomik, i cili përkon me financën si fushë studimi dhe aplikimi. Vetë njësia kryesore që ofron programin është themeluar në vitin 2006, me ofrimin e programeve ekskluzivisht financiare dhe kontabël në përmbajtje. Programi i studimit është klasifikuar korrekt në nivelin 6 të kornizës shqiptare të kualifikimeve, mbështetur në Ligjin 10247/2010, ndryshuar me Ligjin 23/2018. Po kështu, kodifikimi është bërë me numrin 63BA0412S, në përputhje me udhëzimet e dhëna në VKM nr. 310, dt. 11.15.2022 dhe Udhëzimin pasues nr. 31, dt. 15.11.2022.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Baza ligjore dhe nënligjore e sipërcituar</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.1 – Mendimi i Dekanit të njësisë kryesore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.2 – Rregullore e njësisë kryesore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.0.1 – Mendimi i Dekanit të njësisë kryesore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.5 – Plani strategjik i programit të studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.7 – Dosja e programit të studimit</i></li> </ul>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Referuar dokumentacionit të depozituar dhe nga informacionet e marra përgjatë vizitës 2-ditore në terren, institucioni të krijon bindjen e arsyeshme se ofron një program studimi Bachelor në Financë, në përputhje me misionin dhe qëllimet e sanksionuara në dokumentet e veta statutore dhe rregullative, në linjë me fushën dhe fokusin akademik të njësisë kryesore ku është akomoduar dhe në përpyekje dinamike për të ruajtur interesat dhe vlerat kombëtare, duke i integruar me ato evropiane e më gjerë.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th><b>Përmbushet pjesërisht</b></th> <th><b>Përmbushet kryesisht</b></th> <th><b>Përmbushet plotësisht</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

**Standardi I.2**

<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Bachelor në Financë, statuti dhe rregullorja institucionale parashikojnë një sërë procedurash që kërkojnë angazhimin e pothuajse të gjitha palëve brenda-institucionale. Detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë përshkruhen qartazi në statut dhe detajohen më tej në rregulloret e niveleve të mëposhtme. Sekretaria Mësimore dhe Sektori i Burimeve Njerëzore mund të jenë më të kujdesshëm në përmbushjen e objektivave të tyre, ashtu sikurse parashihihen në dokumentet rregullatore të institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.1 – Statuti i KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.3 – Rregullore e KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.4 – Rregullore e NJBSC</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.6 – Rregullore e Burimeve Njerëzore dhe Protokollit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.10 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.3 – Rregullore e FE KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.2 – Rregullore e njësisë bazë</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.4 – Rregullore e Programit të Studimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në listën e marrëveshjeve që përmban angazhimet e KUQ me institucione të tjera, vërehen një numër i madh syresh, vendase dhe të huaj, akademike apo të sektorit privat e publik. Nga takimet me stafin dhe studentët konfirmohet vënia në jetë e një pjesë të mirë të pikave që përmbajnë marrëveshjet, si për avancimin e stafit në karrierën akademike, ashtu edhe për praktikant profesional dhe mobilitetin e studentëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.18 – Lista e marrëveshjeve të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.19 – Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave</p>	<p>Marrëveshjet e bashkëpunimit, të listuara në dokumentacionin e depozituar, janë të shumta në numër dhe të larmishme në përmbajtje. Gjithashtu, kolegji, duke angazhuar në stafin e tij akademik profesionistë të fushës, që ushtrojnë aktivitetet biznesi, ka krijuar mundësi të mira për ofrimin e praktikave profesionale, praktikave të punës dhe mentorimin e pedagogëve të rinj. Për numrin e studentëve dhe pedagogëve të</p>

profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	angazhuar, numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit duket se është më shumë sesa optimal.			
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.18 – Lista e marrëveshjeve të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.19 – Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet</i></li> </ul>			
<b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Njësia bazë ka hartuar raport të monitorimit mbi performancën në kohë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, por është e vështirë të identifikohet periudha të cilën mbulon ky raport, si edhe periodiciteti i tij. Informacioni i përket viteve 2018-2022 dhe vetë hartuesi i raportit rekomandon se duhet bërë një analizë të paktën një herë në vit, por pa e adresuar se ku shkon ky rekomandim. Në tërësinë e vet raporti është narrativ dhe mungojnë info-grafikët që ilustrojnë arritjen e objektivave në këtë drejtim. <i>Sugjerohet hartimi i një raporti më të plotë, si edhe adresimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve në kohë dhe palë interesi, për të arritur objektivat e parashtruara në planin strategjik të programit dhe në linjë me planin buxhetor.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.19 – Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Referuar dokumentacionit të depozituar dhe nga informacionet e marra përgjatë vizitës 2-ditore në terren, institucioni duket se ka vendosur marrëdhënie të shumta bashkëpunimi, të sanksionuara këto në marrëveshje me aktorë të ndryshëm akademikë, biznesi dhe të tjerë. Këto marrëdhënie ndihmojnë studentët dhe stafin në arritjen e objektivave të tyre akademike, sikurse edhe shoqërinë në tërësi, për të pasur një fuqi punëtore të orientuar dhe të kualifikuar sipas nevojave. Dokumentimi i punës në këtë drejtim mund dhe duhet të jetë edhe më i plotë, për të gjurmuar performancën ndër vite, sikurse edhe për të rritur imazhin institucional në thithjen e studentëve të rinj dhe pedagogëve të përkushtuar.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në dokumentet e depozituara nga subjekti, programi i studimit nën vlerësim është i ndarë në lëndë e module, në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, ndryshuar me VKM nr. 879, dt. 18.12.2019. Po kështu, ndarja në module dhe lëndë vlerësohet me kredite, sipas ECTS, referuar guidës përkatëse në Hapësirën Europiane të Arsimit. Vetë njësia bazë ka ndryshuar në favor të lëndëve karakterizuese dhe atyre bazë, strukturën e programit të studimit, referuar shkresës së dt. 20.09.2020. Sipas kësaj shkrese janë shtuar kreditet për lëndët e profesionit, sikurse është hequr një lëndë me orientim bankar dhe është shtuar një tjetër me orientim marketing.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.9 – Programi mësimor</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.2 – Kreditet sipas veprimtarive të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.3 – Relacion shpjegues për programin</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të</p>	<p>Në bazë të lëndëve dhe ndarjes së tyre sipas tipit, referuar programit mësimor të depozituar, konstatohet një shpërndarje e balancuar dhe e larmishme e dijeve dhe aftësive profesionale që programi synon të përçojë. Lëndët financiare përbëjnë peshën kryesore të programit me mbi 65% të totalit të krediteve. Gjithsesi, një pjesë e lëndëve zhvillohen nëpërmjet një literature që ka <u>nevojë të përditësohet</u> me ndryshimet e fundit teknologjike dhe të përshtatet me kushtet dhe rregullat e mjedisit dhe sfidave ekonomike e sociale të vendit tonë. Pedagogët që i lëvrojnë lëndët, në pjesën më të madhe, kanë një eksperiencë dhe profesionalizëm të konsiderueshëm, gjë që ndihmon në adresimin dhe zgjidhjen me korrektësi dhe nivel të lartë të problemeve që programi i studimit trajton.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.9 – Programi mësimor</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.2 – Kreditet sipas veprimtarive të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.3 – Relacion shpjegues për programin</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>



specializuar studimi ose profesionale.	
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Referuar dokumentacionit të depozituar, lëndët janë të grupuara në kategoritë përkatëse, konform kërkesave ligjore dhe rregullative. Secila lëndë shoqërohet me numrin e krediteve që mbart. Syllabuset e lëndëve detajojnë më pas veprimtaritë e nevojshme për të përfituar kreditet, konform sistemit përkatës të vlerësimit. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.2 – Kreditet sipas veprimtarive të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Referuar dokumentacionit të depozituar, është e përcaktuar qartë ngarkesa në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse. Kjo ngarkesë ka pësuar një ndryshim në vitin 2020, por konform bazës ligjore dhe rregullative, sanksionuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.2 – Kreditet sipas veprimtarive të programit</i></li> </ul>
<b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	E paaplikueshme për institucionin nën vlerësim. KUQ nuk është IAL me status të veçantë.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	E paaplikueshme për subjektin nën vlerësim. Nga dokumentacioni dhe vizita në KUQ nuk u konstatua se ofrohen programe me të njëjtën emërtesë.

<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në dokumentacionin e depozituar nga subjekti, konstatohet një shkresë e cila, referuar bazës ligjore përkatëse, propozon kodifikimin e programit të studimit dhe më tej të lëndëve përbërëse të programit. Shkresa, ndonëse është propozim, nuk përmban se kujt i drejtohet dhe nuk pasohet nga ndonjë vendim i titullarit. Në këtë shkresë, kodifikimi në çdo nivel është bërë në përputhje me fushën e studimit, sipas klasifikimit të publikuar nga MASR.</p> <p>▪ <i>Aneks 3.34 – Propozim për kodet e programit</i></p>								
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>E paaplikueshme për subjektin nën vlerësim. Ky program nuk ofrohet në formë të përbashkët.</p>								
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga dokumentet e depozituara, si edhe konstatimet përgjatë vizitës inspektuese, programi i studimit rezulton i organizuar në përputhje me bazën ligjore e rregullative kombëtare dhe, atje ku është e aplikueshme, edhe ndërkombëtare.</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 1149 762 1227">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="770 1149 954 1227">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="962 1149 1137 1227">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1145 1149 1327 1227">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 1227 762 1274"></td> <td data-bbox="770 1227 954 1274"></td> <td data-bbox="962 1227 1137 1274"></td> <td data-bbox="1145 1227 1327 1274">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet</p>	<p>Konform VKM-së 418, dt. 10.05.2017, personeli akademik me kohë të plotë i dept. përbëhet sipas dokumentacionit të depozituar nga 7 anëtarë (aneksi 3.10, aneksi 2.6 &amp; dok. nr. 9), 3 prej të cilëve mbajnë grada shkencore dhe tituj akademikë. Fakulteti Ekonomik ka në përbërjen e tij tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Financës;</li> <li>2. Departamenti i Menaxhim Biznesit;</li> <li>3. Qendër Kërkimore Shkencore FE;</li> </ol> <p>Për realizimin e programit të studimit, rezultojnë të angazhuar në total 23 pedagogë (aneksi 3.11), 14 prej të cilëve janë staf akademik</p>



<p>akademike, vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>efektiv i KUQ, ndërsa pjesa tjetër staf me kontratë. Nga 27 modulet që zhvillohen në program, stafi akademik efektiv përballon 18 lëndë, që në kredite përfaqësojnë mbi 70% të ngarkesës mësimore, konform VKM-së së sipërcituar. (aneksi 3.11, aneksi 3.13 &amp; aneksi 3.14)</p> <p>Gjithsesi, nëse kryqëzohen të dhënat e përmbajtura në dokumentet e ngarkesës mësimore 2022-2023 (aneksi 3.13), stafet akademike të angazhuara për periudhën 2020-2023 (dok. nr. 9), syllabuset e lëndëve për vitin akademik 2022-2023 (aneksi 3.14) dhe CV e stafit akademik përgjegjës për programin (aneksi 3.12), konstatohen disa mosrakordime dhe konkretisht:</p> <p>a) Në dokumentin e stafit të angazhuar, rezulton si pedagoge efektive e dept. përgjegjës për programin e studimit në dy vitet e fundit, znj. B. V. Kjo pedagoge nuk figuron me ngarkesë mësimore në dokumentin e ngarkesës dhe as nuk është pjesë e syllabuseve dhe CV të depozituara për këtë program studimi. Në dokumentin e CV-ve konstatohet znj. D. C. që mban edhe mbiemrin 'Vosela', por jo B. Vosela.</p> <p>b) Për vitin akademik 2022-2023, në tabelën e stafit të angazhuar rezulton si PAE, z. E.A. Sipas ngarkesës mësimore dhe syllabusit përkatës, ky pedagog rezulton asistent lektor në lëndën Hyrje në Financë, me ngarkesë vjetore 30 orë në këtë program. Në CV-në e tij, depozituar nga KUQ, z. Abazi deklarohet si i punësuar full-time në GSM Albania nga 05.08.2022 e në vijim, por jo i punësuar full-time pranë KUQ, sikurse cilësohet në dokumentet e sipërcituar.</p> <p>c) Në dokumentin e ngarkesës mësimore, znj. D. C. rezulton me ngarkesë mësimore prej 75 orësh (leksione + seminare) në lëndën e Kontabilitetit të Kostos dhe Drejtimit, ndërkohë që në syllabusin e lëndës, figuron asistent lektore krahas titullarit z. A.B., për një ngarkesë prej 35 orësh në seminare. Në dokumentin e ngarkesës mësimore, z. Binaj nuk figuron lektor në këtë lëndë.</p> <p>d) E njëjta situatë si në pikën (c) më lart, përsëritet me ngarkesën mësimore në Analizë Financiare, Financë Publike dhe Investime, ku nuk është e qartë se si është e ndarë ngarkesa, referuar dokumenteve të ndryshme.</p> <p>Vlerësimi i performancës për strukturën dhe stafet akademike, bazuar në dokumentacionin e depozituar, është bërë përmes pyetësorëve me palët e përfshira në mësimdhënie dhe mësimnxënie, inspektime të kontrollit të cilësisë dhe mbledhjet apo analizat e njësisë bazë, të gjitha këto veprime të parashikuara në rregullore dhe akte të tjera institucionale.</p>
---	---



Cilësia e stafit të Departamentit të Financës						
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	2	-	2	1	2	1
Prof.Asoc.	-	-	-	2	-	2
Dr	2	1	1	1	1	1
Msc	3	1	4	-	4	-
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>7</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>4</b>

- *Aneks 3.10 – Stafit akademik i njësisë bazë*
- *Aneks 2.6 – Stafit akademik sipas dept. në FE KUQ*
- *Dok. nr. 9 – Tabelat për stafin e angazhuar 3 vitet e fundit akademike*
- *Aneks 3.11 – Stafit akademik i angazhuar*
- *Aneks 3.13 – Ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar*
- *Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve*
- *Aneks 3.12 – CV-të e stafit të angazhuar*
- *Aneks 3.1 – Plan-veprimi për rekomandimet e BA ASCAL*

**Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Nga dokumentet e konsultuara (aneksi 1.1 -statuti KUQ) konstatohet se parashikimet statuore të institucionit janë në linjë me parashikimet ligjore e nënligjore, sikurse përmbahen në Kreun VI, nenet 66-67 të Ligjit 80/2015. Gjithashtu, institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh për stafin mbështetës (aneksi 1.6, aneksi 1.9, aneksi 1.10, aneksi 1.11, aneksi 2.5) të cilat dëshmojnë se angazhimi i stafit ndihmës-akademik e administrativ është formalisht i rregulluar në formë dhe në përmbajtje. Nëse i referohemi aneksit 3.15 – *Formati i aplikimit të studentit në praktikë*, konstatohet se dorëzimi i dokumentacionit bëhet tek “pedagogu përgjegjës për praktikën”, pra mungon një personel i dedikuar ndihmës-akademik në këtë aspekt. Në rregulloren e njësisë kryesore, atë bazë dhe të praktikës profesionale, citohet ngritja e një Komisioni për Praktikën Profesionale, por këto dokumente nuk shpjegojnë përmbajtjen e këtij Komisioni, “përgjegjës për të gjitha çështjet e organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale”. Po kështu, në dokumentacionin e depozituar në ASCAL mungojnë kontratat për personelin ndihmës-akademik e atë administrativ të lidhur me këtë program studimi, apo tabelat përmbledhëse për to, me përjashtim të vendimit për koordinatorin e programit, që trajtohet në vijim. Vetë rregullorja e praktikës profesionale thekson se çdo dokument për praktikën

	<p>tërhiqet tek Drejtuesi i Departamentit, duke anashkaluar personelin ndihmës në këtë drejtim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.1 – Statuti i KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.6 – Rregullore e HR dhe Protokollit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.9 – Rregullore e PR dhe Karrierës</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.10 – Rregullore e Sekretarisë Mësimore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.11 – Rregullore e Bibliotekës</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.5 - Rregullore e Qendrës së Kërkimit FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.15 – Formatit i aplikimit të studentit në praktikë</i></li> </ul>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Nga materiali i përmbajtur në aneksin 3.8 konstatohet vendimi për caktimin e koordinatorit të programit të studimit. Ky vendim mban datën 12.10.2022. Caktimi i koordinatorit dhe detyrat e tij parashihen në nenin 25 të Rregullores së Programit të Studimit (aneksi 3.4). Si koordinator i programit të studimit është caktuar një pedagog që, nga <i>Aneksi 3.11 – Stafit i angazhuar në program</i>, figuron PAE në një dept. tjetër brenda KUQ, ndërsa, sipas <i>Aneksit 3.12 – CV-të e stafit të angazhuar</i>, figuron lektor me kohë të plotë dhe përgjegjës departamenti i arkitekturës, në një Kolegj Jopublik në qytetin e Vlorës, pra rrjedhimisht PAK në KUQ. Nga detyrat e përmbajtura për këtë pozicion në rregulloren e programit, konstatohen mospërputhje midis formimit akademik të koordinatorit dhe kontributeve që ai duhet të japë në marrëdhënie me studentët dhe stafin akademik të angazhuar në program.</p> <p><i>Do të ishte më e përshtatshme, në bazë të detyrave që parasheh rregullorja për këtë pozicion, të caktohej si koordinator një pedagog brenda njësive bazë që ofron programin e studimit.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.8 – Vendim për emërimin e koordinatorit të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.4 – Rregullore e programit të studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.11 – Stafit i angazhuar në program</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.12 – CV-të e stafit të angazhuar</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Dokumentacioni i depozituar nga subjekti lidhur me këtë kriter figuron i paplotë, i papërditësuar dhe në disa raste kontradiktor. Formalisht, kriteret e këtij subjekti konsiderohen të përmbushura, por nga pikëpamja përmbajtjesore ka vend për përmirësim të mëtejshëm.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i depozituar, konstatohet se në çdo akt institucional është referuar baza e duhur ligjore e nënligjore mbështetëse, si burim kryesor për organizimin e duhur të studimeve në këtë program. Në terma të përmbajtjes së kurrikulës, është ruajtur balanca e lëndëve sipas kërkesave ligjore, por edhe praktikave të mira, vendase e të huaja në këtë drejtim. Mbetet ende sfidë profilizimi i kurrikulës, për të krijuar një përputhje apo avantazh konkurrues në ofertën akademike, përkundrejt IAL-ve të tjera në treg.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e Statutit dhe Rregulloreve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Në aneksin 3.9 përmbahet programi mësimor i studimit, ndërsa në aneksin 3.9.1. plani mësimor përkatës. Informacioni i përmbajtur në këto dokumente është i detajuar në kredite, semestra, lëndë dhe module, orë brenda dhe jashtë auditorit.</p> <p>Nëse krahasohen këto dokumente ka disa mospërputhje mes tyre. Kështu:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lënda “Anglisht 1” në semestrin e parë të vitit I, figuron me 15 orë javore në aneksin 3.9, por vetëm me 2 orë javore në aneksin 3.9.1. Këto përlllogaritje janë mbartur në nxjerrjen e totalit javor, duke e deformuar atë në aneksin 3.1. Nga kryqëzimi me dokumentin e syllabuseve, kjo lëndë figuron me 2 orë javore.</li> <li>2. E njëjta problematikë konstatohet me lëndën “Anglisht 2” në semestrin e dytë të vitit I.</li> <li>3. Po kështu, lënda “Anglisht 2” e ka të përlllogaritur gabim totalin e orëve gjithsej për studentin. Në përputhje me germën ‘b’, të pikës 2.1, të VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, kjo lëndë përmban 3 kredite dhe rrjedhimisht i korrespondojnë 75 orë mësimore pune të studentit. Aneksi 3.9 e pasqyron këtë lëndë me 30 orë në auditor, 75 orë punë të pavarur dhe 105 orë mësimore në total. Ky gabim nuk është mbartur në totalin e orëve për këtë semestër, duke e pasqyruar këtë total të saktë. Mbetet për t’u korrektuar numri i orëve të punës së pavarur të studentit.</li> </ol>

	<p>4. E njëjta problematikë vihet re tek lëndët “Financë Publike” dhe “Investime” në semestrin e dytë të vitit III, po tek aneksi 3.9. Këto lëndë nuk reflektojnë numrin korrekt të orëve mësimore gjithsej për studentin, në raport me kreditet që përmbajnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.9 – Programi i studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Dokumenti institucional fillestar që rregullon kërkesat e këtij kriteri, është statuti, në nenet 39 dhe 42 të tij. Rregulloret e njësisë kryesore dhe asaj bazë, bëjnë më tej detajimet përkatëse në këtë drejtim. Gjithashtu, në aneksin 1.25 jepen kriteret, koeficientët dhe formula përlllogaritëse për pranimin në këtë program studimi, duke respektuar kriterin e mesatares së vendosur nga Këshilli i Ministrave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e Statutit dhe Rregulloreve</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 1.25 – Kriteret e pranimit të studentëve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga dokumentet e konsultuara, programi ofron informacionet e duhura në përputhje me këtë kriter, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Syllabuset, programi dhe plani mësimor janë në përputhje me formatet e miratuara nga aktet ligjore, por mbetet të korrektohen mosrakordimet në shifra, sikurse u citua në kriterin 2 më lart.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9 – Programi i studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Dokumentet e depozituara lidhur me përmbajtjen e programit të studimit dhe kryesisht syllabuset, i përkasin vitit akademik 2022-2023. Për të konkluduar bindshëm mbi kërkesat e këtij kriteri, duhet të ishin depozituar edhe syllabuset e dy viteve vijuese nga akreditimi i fundit (2019-2020 dhe 2020-2021), në mënyrë që të mundësohej krahasimi dinamik i përmbajtjes së kurrikulës në ofertën akademike të programit. Ashtu sikurse u pasqyrua në shtjellimin e kriterit 1 të standardit II.2 më lart, programi ka pësuar ndryshime në peshën e krediteve që mbartin grup-lëndët e të pesë kategorive që specifikon VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, duke hequr gjithashtu një lëndë</p>



	<p>financiare dhe futur një lëndë biznesi, ndonëse ky ndryshim nuk përkon siç duhet me rekomandimet e lëna nga akreditimi paraardhës.</p> <p>Nëse i referohemi literaturës së shfrytëzuar sipas aneksit të syllabuseve, konstatohet se literatura më e re i përket viteve 2016-2019 në masën afro 30% të totalit të moduleve, ndërsa ajo më e hershme viteve 2010-2015 për pjesën e mbetur. Vetëm në modulën e Komunikimit në Biznes (lëndë me zgjedhje) literatura është e vitit 2021. Nga vizita inspektuese në terren, konstatohet se pedagogët e moduleve të programit përditësojnë studentët me informacionet më të fundit në fushat që mbulojnë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.3 – Relacion shpjegues për programin</i></li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga dokumentet e konsultuara rezulton se programi i studimit është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet ligjore. Informacionet për pranimin, transferimin dhe diplomimin në program janë të qarta dhe shterruese. Kolegji mund të përmirësohet edhe më tej në pasurimin e programit dhe diferencimin e tij karshi IAL-ve konkurrenente.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Lëndët që zhvillohen në këtë program dhe literatura mbi të cilën ato mbështeten janë të përshtatshme për nivelin Bachelor, në përputhje me nivelin 6 të Niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sikurse përmbahen në Ligjin 10247/2010. Lëndët variojnë nga bazike në menaxheriale, strukturuar progresivisht sipas viteve të studimit, duke krijuar në këtë mënyrë një hierarki optimale të mësimnxënies dhe avancimit akademik. Në kurrikul nuk janë përfshirë lëndë që i përkasin niveleve më të larta akademike, por në lëndët e përfshira hidhen bazat e shëndosha për nxënien e këtyre dijeve, nëse studenti vendos të avancojë me</p>

	<p>studime të mëtejshme. Për shkak të zhvillimit të ulët financiar dhe përgjithësisht ekonomik në vendin tonë, programi i studimit ofron dije më të avancuara nga sa konsumon aktualisht tregu i punës në Shqipëri. Programi ka potencial për të përfshirë paksa më shumë lëndë juridike në kurrikul, meqenëse aspekti juridik, por edhe ai etik i kodifikuar në norma juridike, është vital kudo, por veçanërisht për Shqipërinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Objektivat formues të programit parashtrohen në <i>Aneksin 3.5 – Plani Strategjik i Programit</i>. Sikurse cituar më lart, këto objektiva nuk janë në formën SMART, por gjithsesi ato synojnë përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar, kontributin në zhvillimin ekonomik dhe avancimin përmes dijes dhe kërkimit shkencor. Strukturimi dhe dizenjimi i lëndëve dhe mënyra e zhvillimit dhe kontrollit të tyre duket se kontribuojnë në këtë drejtim. Pesha më e madhe e krediteve shkon për lëndët e profesionit dhe rrjedhimisht edhe orët mësimore, brenda e jashtë auditorit, ndjekin të njëjtën linjë. Numri i orëve mësimore për çdo vit është 1500, duke reflektuar 60 kreditet vjetore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore. Pesha e orëve mësimore në auditor vjen duke u ulur nga viti i parë në vitet pasardhëse, duke ia lënë vendin orëve të punës së pavarur.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.5 – Plani Strategjik i Programit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>KUQ ka krijuar një program studimi të ngjashëm me programe të tilla në universitete të huaja e vendase. Programi zhvillohet në tri vite, me 60 kredite secili, ashtu sikurse sanksionohet në Kartën e Bolonjës, përqaftuar nga mbi 52 vende europiane. Plani strategjik i programit, i cili vendos në perspektivë zhvillimin e tij, mund të përmbante referenca të ngjashmërive mes tij dhe programeve të universiteteve rajonale apo europiane, me të cilat KUQ ka vendosur apo mund të vendosë ura bashkëpunimi, edhe për të ofruar diploma dyfishe në këtë fushë, si pjesë e udhëzimeve të MASR në këtë drejtim. Raporti teori-praktikë ndjek modelin e IAL-ve të tjera në vend, ku semestri i dytë i vitit të fundit i dedikohet praktikës profesionale, me qëllim realizimin e temës së diplomës dhe futjes graduale në tregun e punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.5 – Plani Strategjik i Programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>																										
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese, sikurse parashikohen në dokumentin e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve, janë në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 41, dt. 24.01.2018. Raporti midis formimit teorik dhe atij praktik është optimal dhe i ngjashëm me ato të IAL-ve të tjera vendase e të huaja, duke krijuar kështu mundësinë e transferimit apo mobilitetit brenda e jashtë vendit. Sikurse cituar më lart, dijet dhe aftësitë e ofruara nga ky program, janë mbi nivelin e dijeve apo aftësive që kërkon tregu i punës në Shqipëri, që për fat të keq mbetet ende një treg bazik dhe i padiferencuar.</p> <table border="1" data-bbox="576 730 1315 1296"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kategoria /</th> <th rowspan="2">Përqindja Krediteve Sipas VKM</th> <th colspan="2">Programi Bsc Financë</th> </tr> <tr> <th>Kredite</th> <th>Përqindje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A. LËNDË BAZË</td> <td>15-20%</td> <td>31</td> <td>17,2%</td> </tr> <tr> <td>B. LËNDË KARAKTERIZUESE</td> <td>50-55%</td> <td>97</td> <td>53,9%</td> </tr> <tr> <td>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE</td> <td>12-15%</td> <td>26</td> <td>14,4%</td> </tr> <tr> <td>D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)</td> <td>10-15%</td> <td>19</td> <td>10,6%</td> </tr> <tr> <td>E. DETYRIME PËRMBYLLËSE</td> <td>3- 5%</td> <td>7</td> <td>3,9%</td> </tr> </tbody> </table> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.5 – Plani Strategjik i Programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>	Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM	Programi Bsc Financë		Kredite	Përqindje	A. LËNDË BAZË	15-20%	31	17,2%	B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50-55%	97	53,9%	C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12-15%	26	14,4%	D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10-15%	19	10,6%	E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3- 5%	7	3,9%
Kategoria /	Përqindja Krediteve Sipas VKM			Programi Bsc Financë																							
		Kredite	Përqindje																								
A. LËNDË BAZË	15-20%	31	17,2%																								
B. LËNDË KARAKTERIZUESE	50-55%	97	53,9%																								
C. LËNDË NDËRDISIPLINORE	12-15%	26	14,4%																								
D. LËNDË PLOTËSUESE (Praktika)	10-15%	19	10,6%																								
E. DETYRIME PËRMBYLLËSE	3- 5%	7	3,9%																								
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën</p>	<p>Sikurse shtjelluar në kriterin 5, të standardit II.3, për të konkluduar bindshëm në këtë aspekt, subjekti duhet të kishte depozituar jo vetëm syllabuset e një viti të vetëm akademik, por të disa viteve të njëpasnjëshme. Literatura e përdorur në këtë program është e ngjashme me atë që përdoret në programe në ngjashme në IAL të tjera brenda vendit. Literatura është arsyeshëm bashkëkohore dhe jep dije më të avancuara nga sa mund të konsumojë tregu aktual i punës në Shqipëri.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>																										



bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.									
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Në tërësinë e vet, programi i studimit ofron dijet e duhura dhe bashkëkohore për këdo që studion sistematikisht dhe me përkushtim e kuriozitet shkencor. Pedagogët lëvrues të moduleve ofrojnë një eksperiencë dhe përvojë të gjerë, që shton garancinë për arritjen e objektivave të programit. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Sikurse shtjelluar më lart, në kriterin 1 të këtij standardi, programi ofron të gjitha dijet paraprake për avancimin akademik apo profesional të studentëve të interesuar, duke tejkaluar pritshmëritë e tregut të punës në Shqipëri. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.5 – Plani Strategjik i Programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit të studimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Programi i studimit duket se është në përputhje me standardet e kriteret vendase e të huaja për formimin, kualifikimin, avancimin akademik dhe përshtatjen me tregun e punës brenda e jashtë vendit</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse	Një pjesë e mirë e moduleve përbërëse të programit të studimit lëvrohen nga profesionistë, të cilët ushtrojnë profesionin e kontabilistit apo financierit në sektorin privat, të shoqërisë civile apo edhe publik në rolin e konsulentit. Prania e kësaj pjese të stafit akademik garanton përfshirjen e kërkesave të tregut të punës në hartimin dhe mbarëvajtjen e kurrikulës dhe praktikave profesionale në mbështetje të tyre. Po kështu, nisur nga marrëveshjet e bashkëpunimit, të konstatuara në aneksin 1.8 e aneksin 3.18 dhe të relatuar në aneksin 3.19, krijohet



<p>konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>bindja e arsyeshme se subjekti i përdor pozitivisht palët e treta në krijimin e një programi studimi bashkëkohor dhe të kërkuar nga tregu. Mbetet që këto përfitime dhe konsultimi me të tretë të marrin një formë më të organizuar në planin strategjik të programit, ku të jepet eksperiencia e fituar nga këto marrëveshje në të kaluarën dhe të përcaktohen konkretisht objektivat për të ardhmen.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.8 – Marrëveshjet e bashkëpunimit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.18 – Lista e marrëveshjeve të programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.19 – Raport i përfitimit nga marrëveshjet</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga konsultimi me materialet e depozituara, konstatohet se aktet statutorë dhe rregullatore të Kolegjit i njohin të drejtën studentit për të kontribuar në drejtim përmirësimit të programit të studimit. Po kështu, aneksi 3.20.1 dhe aneksi 3.20.2 dëshmojnë se subjekti përdor pyetësorë, për të gjurmuar ndër të tjera edhe komentet e sugjerimet e studentëve që diplomohen lidhur me përmbajtjen e programit të studimit. Nga takimi me studentët përgjatë vizitave në terren, konfirmohet pjesëmarrja e tyre me sugjerime apo komente për tema të veçanta që duan t'i shohin të pasqyruara dhe të lëvruara në orën e mësimit.</p> <p>Gjithsesi, sikurse përmendur më lart, në dokumentin që përmban relacionin për “<i>Ndryshime në planin mësimor</i>” më dt. 20.09.2020, ku konstatohet ndryshim në numrin e krediteve për një sërë lëndësh, si edhe heqja e një lënde bankare (financiare) dhe futja e një lënde marketingu (biznesi) nuk jepen referenca të mjaftueshme për arsyet e këtij ndryshimi, përfshirë edhe sugjerimet e studentëve apo palëve të tjera. Relacioni përmend si arsye “<i>konstatimet dhe sugjerimet e njësisë mësimore</i>”, si edhe synimin e programit të studimit, por nuk është i detajuar apo referuar mjaftueshëm se si buroi nevoja për këtë ndryshim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e Statutit dhe Rregulloreve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.20.1 – Pyetësor për studentët që diplomohen</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.20.2 – Pyetësor për gjurmimin e studentëve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në</p>	<p>Nga dokumentet e depozituara, sikurse theksuar më lart, programi i studimit ka ndryshuar në vitin 2020, sa i përket shpërndarjes së peshës së krediteve, duke i dhënë përparësi lëndëve karakterizuese, atyre bazë dhe detyrimeve përmbyllëse. Në përmbajtje, konsultimi me syllabuset e lëndës e bën të pamundur analizimin e dinamikës së tyre në vite të ndryshme akademike, sepse janë depozituar vetëm syllabuset</p>

<p>bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>për vitin akademik 2022-2023. <u>Literatura e përdorur, sipas këtyre syllabuseve, në pjesën më të madhe i përket viteve 2010-2015.</u> Një pjesë e mirë e pedagogëve që lëvrojnë këto syllabuse janë profesionistë në fushat e tyre dhe njohin mirë aspektet financiare, fiskale, kontabël, juridike e ekonomike të specialiteteve të tyre. Po kështu, janë pjesë e shoqatave kontabël e financiare brenda vendit, sikurse kanë punuar edhe për institucione kyç financiare, fiskale e audituese në sektorin publik. Të gjitha sa më lart përbëjnë një garanci që, në formë të shkruar dhe/ose verbale, programi i studimit përmirësohet, përditësohet e përshtatet vazhdimisht.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</li> <li>▪ Aneks 3.12 – CV-të e stafit të angazhuar</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit që ofron KUQ për drejtuesit financiarë, është një program që ushqehet vazhdimisht nga një sërë burimesh. Dokumentet e depozituara dhe takimet në terren konfirmojnë përfshirjen e studentëve dhe profesionistëve në përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Mbetet vetëm për t'u pasqyruar më mirë në letra dhe dokumente vendim-marrëse se si reflektohet mbi vendimet e marra dhe nga lind nevoja e si implementohet ndryshimi</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Referuar anekseve që përmbajnë planin mësimor, syllabuset, si edhe rregulloret e të çdo niveli, konstatohet se institucioni përdor të gjitha format e veprimtarive mësimore të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore. Gjithashtu, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit, KUQ organizon leksione të hapura me folës të ftuar nga bota e biznesit, administratës publike, shoqërisë civile, etj., për të përmbushur me sukses objektivat mësimdhënëse. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9.1 – Plani mësimor i programit</i></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga vizitat inspektuese, studentët dhe stafi akademik konfirmuan se mësimi zhvillohet në disa forma të kombinuara, fizike dhe digjitale, teorike dhe praktike, brenda vendit dhe jashtë vendit, në bazë të mobilitetit të parashikuar në marrëveshje të ndryshme. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita inspektuese</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga aneksi i listës së trajnimeve, konstatohet se KUQ ka ofruar trajnime të larmishme për periudhën 2021-2022. Po kështu, nga vizita në terren, stafi akademik, kryesisht ai i rekrutuar rishtazi, u shpreh i kënaqur me asistencën e ofruar nga institucioni në drejtim të literaturës së kërkuar për një mësimdhënie të frytshme, avancimit në karrierën akademike për marrjen e titujve dhe gradave, si edhe mobilitetit dhe shkëmbimit të eksperiencës me institucione homologe brenda e jashtë vendit. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.25 – Lista e trajnimeve</i></li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në	Sikurse theksuar disa herë më lart, në shtjellimin e kriterëve paraardhëse, stafi akademik i angazhuar në këtë program ka



<p>mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>eksperiencë të konsiderueshme jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në fushat profesionale respektive. Rrjedhimisht kompetencat e tyre në lëvrimin e syllabuseve për të cilat janë përgjegjës konsiderohen mëse optimale. Po kështu, nga takimet me studentët konfirmohet një marrëdhënie e ngrohtë dhe e frytshme bashkëpunimi mes tyre dhe stafit akademik. Për nga vetë natyra e lëndëve, shpjegimi i koncepteve në këtë program shoqërohet me software aplikativë, sikurse edhe mjete të tjera digjitale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.12 – CV-të e stafit të angazhuar</i></li> <li>▪ <i>Vizita inspektuese në subjekt</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Nga <i>Aneksi 3.20 – Pyetësorët me studentët</i>, konstatohet se njësia bazë përpikëqet të vjelë mendimet e studentëve mbi performancën mësimdhënëse në dimensione të ndryshme të saj. Gjithsesi, nuk janë depozituar në bazën dokumentare pyetësorë konkretë të plotësuar apo raporte përmbledhëse për problematikat e ngritura dhe rrugët e zgjidhjes për reflektimin e tyre, sikurse janë depozituar dokumente të ngjashme për mini-kontrollet e cilësisë (<i>aneksi 3.38</i>). Nga takimet në terren nuk u konstatuan problematika në këtë drejtim dhe stafi akademik e studentët dukeshin të kënaqur me metodat mësimdhënëse dhe përditësimin e tyre periodik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.20 – Pyetësorët me studentët</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.38 – Mini-kontrolle të cilësisë</i></li> <li>▪ <i>Vizita inspektuese</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së</p>	<p>Në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, sikurse edhe me Statutin e vet, institucioni ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila, referuar Rregullores së saj, ka si qëllim ndër të tjera edhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Ndonëse RVB përmend raportin e punës së kësaj njësie, të përmbajtur në <i>aneksin 3.36</i>, ky <u><i>aneks nuk gjendet në dokumentet e depozituara fillimisht dhe as në ato të depozituara pas vizitës 2-ditore në subjekt, duke e bërë kështu të pamundur të konstatohet kontributi i kësaj</i></u> Njësie në funksion të qëllimit të saj dhe kërkesave të këtij kriteri. Nëse i referohemi <i>Aneksit 3.32 – Pyetësor për pedagogun</i>,</p>



<p>mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin të metodave të reja.</p>	<p>konstatohet se në të përbahen pyetje që lidhen me cilësinë e mësim-dhënies në aspektin akademik dhe atë logjistik, por sërish, sikurse në rastin e pyetësorëve të studentëve në kriterin më sipër, nuk gjenden pyetësorë konkretë të plotësuar dhe/ose raporte përmbledhëse që pasqyrojnë problematikat e rezultuara dhe zgjidhjet për përmirësimin e cilësisë. Në dokumentin e trajnimeve të stafit përbahen trajnimet e zhvilluara në formë liste, por nuk ka një relacion shpjegues se si këto trajnime lidhen me kërkesat apo nevojat e konstatuara dhe si kanë kontribuar ato në rritjen e cilësisë.</p> <p>KUQ ka ngritur gjithashtu, si pjesë përbërëse të FE-së, edhe Qendrën Kërkimore-Shkencore. Kjo Qendër, referuar rregullores së saj, synon të kontribuojë në lidhjen e mësimdhënies me kërkimin shkencor për njësitë bazë të FE-së. Nga <i>Aneksi 3.12.1 – Raport mbi kërkimin shkencor për vitin akademik 2021-2022</i>, konstatohet se kjo Qendër është përpjekur të nxjerrë në pah problematikat dhe të parashtrojë objektiva në drejtim edhe të cilësisë së mësimdhënies, por konkluzioni i punës së saj për këtë vit akademik përmbledhet si: “veprimtaria studimore e shkencore në nivel fakulteti rezulton me tregues jo të kënaqshëm...”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.32 – Pyetësor për pedagogun</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.25 – Lista e trajnimeve</i></li> <li>▪ <i>Aneksi 3.12.1 – Raport mbi kërkimin shkencor për vitin akademik 2021-2022</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KUQ është përpjekur të ofrojë një proces mësimdhënieje e mëximnxënieje bashkëkohor, duke vendosur studentin në qendër të vëmendjes dhe duke reflektuar për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Madhësia e vetë institucionit dikton që ky proces të jetë gradual dhe përgjithësisht ndjekës i praktikave të IAL-ve të tjera më të mëdha. Avantazhi i KUQ qëndron tek stafi akademik i angazhuar, që zotëron eksperiencë dhe lidhje të shumta me botën e biznesit. Gjithsesi, dokumentimi i proceseve dhe reflektimi i tyre në kohë duhet të bëhet më me kujdes.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi III.2**



<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/Rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një sërë rregulloresh në nivel kolegji, fakulteti dhe dept., që adresojnë çështjet e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Po kështu ekziston edhe një rregullore e posaçme e programit të studimit, që prek vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale. Rregullorja institucionale është e publikuar në website të institucionit, por rregulloret e tjera në nivel fakulteti/njësie bazë/programi nuk gjenden aty.</p> <p>Rregulloret duket se janë në linjë dhe plotësojnë njëra-tjetrën, por gjithsesi hasen edhe raste kur konfliktojnë në rregullat që parashtrajnë për studentin. Konkretisht, duke iu referuar formës së vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rregullorja e fakultetit, në nenin 58 të saj sanksionon se frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%, ndërkohë që rregullorja e njësisë bazë cilëson në nenin 27 të saj, se frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 80%. Rregullorja e programit të studimit i përmbahet rregullores së dept., dhe e ka këtë frekuentim të detyrueshëm në masën 80%.</li> <li>2. Rregullorja e fakultetit dhe ajo e njësisë bazë, sikurse theksuar më lart, lë si afat në rast ankimi të studentëve, 48 orë nga shpallja e rezultatit në sistem, ndërkohë që rregullorja e programit lë si afat 48 orë nga data e dhënies së provimit. Rikujtojmë se afati për hedhjen e rezultateve në sistem është 5 ditë kalendarike nga data e dhënies së provimit.</li> <li>3. Në nenin 37, pika 2, rregullorja e njësisë bazë thekson se studenti në nivel Bachelor, me kohë të plotë, kalon në vitin e tretë nëse ka fituar minimumi 60 kredite. Në nenin 69, pika 2, germa 'b', rregullorja e njësisë kryesore thekson se studenti në nivel Bachelor, me kohë të plotë, kalon në vitin e tretë nëse ka fituar minimumi 80 kredite. Rregullorja e programit të studimit nuk shprehet për këtë aspekt, ndërsa rregullorja e institucionit (nivel kolegji), në nenin 27, germa 'c' thekson se studentët e nivelit Bachelor kalojnë në vit të tretë nëse kanë marrë jo më pak se 80 kredite, nga të cilat jo më pak se 50 kredite nga viti i parë.</li> <li>4. Rregullorja e institucionit (nivel kolegji), në nenin 27, germa 'b', shprehet se studenti i nivelit Bachelor, kalon në vitin e dytë vetëm nëse ka marrë jo më pak se 25 kredite</li> </ol>




	<p>nga viti i parë. Rregulloret në nivel fakulteti dhe dept. e vendosin këtë nivel në minimumi 30 kredite.</p> <p>5. Rregullorja e njësisë bazë, në nenin 37, pika 4, germa 'b' të saj, i referohet nenit 82 të saj, ndërkohë që kjo rregullore ka në fakt 71 nene në total. Kjo është pasojë e kopjimit fjalë-për-fjalë të rregullores së njësisë kryesore, që në fakt nuk ka ndodhur me pikat 1 dhe 3 me lart. Pra janë kopjuar gjëra që s'duhen dhe janë ndryshuar gjërat që duhen.</p> <p>6. Rregullorja e njësisë kryesore, në nenin 82, pika 1, thekson se diplomimi i studentëve të ciklit Bachelor bëhet me një sezon në muajin Korrik. Të njëjtën linjë ruan edhe rregullorja e njësisë bazë, në nenin 50, pika 1 të saj. Ndërkohë, rregullorja e programit të studimit, hartuar ekskluzivisht për këtë program Bachelor, në nenin 21, pika 3, gjerat 'a' dhe 'b', thekson se diplomimi bëhet me dy sezone, një në Korrik dhe një tjetër në vjeshtë (Shtator). Sezoni i Shtatorit, sipas dy rregulloreve të sipër-cituara, rezervohet për studentët e nivelit Master dhe jo ata Bachelor. Po kështu, dy rregulloret e epërme theksojnë se nëse studenti nuk diplomohet në sezonin e tij të rregullt, atëherë ai mund të rifutet në provim formimi apo diplomë vetëm pas 6 muajsh, në sezonin e Marsit, dhe jo në sezonin e vjeshtës (Shtator).</p> <p>Këto mospërputhje dhe të tjera eventuale, sugjerohet të rishihen me kujdes dhe të korrektohen për të patur kritere testimi dhe vlerësimi në unison me njëra-tjetrën.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në secilin prej syllabuseve të konsultuara, konstatohet se sistemi i vlerësimit të vazhduar dhe ai përfundimtar është përfshirë dhe bërë transparent për studentin nga ana e titullarit të lëndës. Sistemi i vlerësimit është konform rregulloreve, me përjashtim të lëndës "Drejtimit Marketingu", ku struktura e vlerësimit është: 20% pikë nga seminarët, 10% detyrë kursi dhe 70% provim përfundimtar, strukturë kjo e paparashikuar në asnjë prej alternativave të përmbajtura në rregulloren e programit të studimit. Rregulloret parashikojnë detyrimin e pedagogut për njoftimin e studentëve lidhur me sistemin e vlerësimit në fillim të semestrit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>




<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga dokumentet e konsultuara rezulton se vlerësimi i njohurive bëhet përmes 4 aktiviteteve apo elementëve vlerësues:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Pjesëmarrjes dhe aktivizimit përgjatë orës së mësimir;</li> <li>2. Detyrës së kursit apo esesë;</li> <li>3. Provimit të pjesshëm;</li> <li>4. Provimit përfundimtar;</li> </ol> <p>Vetë provimet mund të kryhen me shkrim apo verbalisht, ndërkohë që pjesëmarrja, aktivizimi dhe detyrat e kursit mund të përdorin mjete digjitale apo të tjera për një prezantim sa më të mirë të tyre. Elementët e vlerësimit duken të balancuar mes tyre edhe sa i përket peshës së vlerësimit përfundimtar, duke bërë që studentit të ketë një larmi mënyrash për të shfaqur potencialin dhe njohuritë e përfuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sikurse theksuar më lart, gjurmë dokumentare në dokumentet e depozituara, që t'i përgjigjen ekskluzivisht kërkesave të këtij kriteri, nuk gjenden konkretisht. KUQ ka përfshirë një formular të pyetësorëve që realizon me studentët në aneksin 3.20, por ky pyetësor është i paplotësuar dhe nuk mund të konkludohet se si një kërkesë e studentëve mbi metodat e mësimdhënies, është reflektuar në vijim nga pedagogu përkatës. Gjithsesi, nga vizita inspektuese në terren, studentët u shprehën të kënaqur me format dhe metodat e mësimdhënies, sikurse edhe me transparencën institucionale lidhur me mundësitë për përmirësim në këtë drejtim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.20 – Pyetësor për studentët</i></li> <li>▪ <i>Vizita në terren</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë</p>	<p>Nga vizita në terren, konstatohet se institucioni përdor krahas formave klasike të mësimdhënies edhe ato moderne, ku teknologjia zë vendin kryesor. Aksesi në kohë reale në Internet, disponimi i aplikacioneve përpunuese të informacionit dhe paraqitja vizuale e të dhënave të analizuara, janë risi që KUQ i përdor me përparësi. Po kështu, shfrytëzimi i bazave të të dhënave nga institucione të ndryshme financiare brenda e jashtë vendit, u jep mundësi studentëve të realizojnë detyra kurse në mënyrë të pavarur dhe që i aftësojnë për punëzënie të sigurtë në të ardhmen. Sigurisht, në këtë drejtim ka vend për përmirësim të pafundëm me zhvillimin galopant të teknologjisë dhe sugjerohet që KUQ të përmirësojë më tej aksesin në librari</p>





<p>sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>të ndryshme online, si edhe të shtojë prezencën me aktivitetet e veta në botën virtuale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vizita në terren</li> <li>▪ Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KUQ ka hartuar rregullore dhe ka nxjerrë akte e dokumente në zbatim të tyre që garantojnë një sistem vlerësimi transparent dhe të balancuar. Një pjesë e rregulloreve ka mospërputhje në nene të caktuara, që vijnë si rezultat i punës së pakujdesshme të hartuesve të tyre, por në terren, studentët dhe stafi akademik e ndihmës-akademik duken të qartë në realizimin e detyrave të tyre.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

### Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në të gjitha syllabuset e depozituara për vitin akademik 2022-2023 konstatohet se elementët vlerësues shtrihen përgjatë gjithë semestrit kur zhvillohet syllabusi dhe në total përmbajnë jo më shumë se 40% të vlerësimit final, ashtu sikurse e përmbajnë rregulloret. Këto elementë vlerësues testojnë njohuritë në forma të ndryshme si: aktivizim në klasë, detyrë kursi, ese, provim me gojë ose me shkrim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Përfshirja e sistemeve elektronike të testimit në këtë program studimi nuk konstatohet as në dokumentet e depozituara dhe as në vizitën inspektuese në terren. RVB referon aneksin 1.23 si dokument justifikues të këtij kriteri, por ky dokument përmban udhëzime se si përdoret Google Classroom, por jo materiale se si janë kryer në realitet vlerësimet apo testimet në këtë platformë.</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>e-ASCAL</i></li> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës është një shumatore e vlerësimit përgjatë semestrit me provimin final. Ky vlerësim është në përputhje me sa parashihet në VKM nr. 41, dt 24.01.2018, sikurse edhe me aktet rregullatore të vetë institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>VKM 41/2018</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Për të vlerësuar konkretisht kërkesat e këtij kriteri dhe referuar me dokumentacion ato, subjekti do të duhej të kishte depozituar disa fletë provimesh, detyrash kursi, etj, me komentet dhe sugjerimet e pedagogut apo edhe komunikime elektronike për përmirësimin e performancës së studentit në të ardhmen. Gjithsesi, nga takimi me studentët në vizitën në institucion, ata u shprehën të kënaqur nga asistenca që merrnin nga pedagogët në drejtim të rritjes dhe avancimit të tyre akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>e-ASCAL</i></li> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Rregulloret e njësisë themelore dhe të njësisë bazë shprehen kategorikisht kundër plagjiaturës dhe kopjes në provim apo detyra, duke e penalizuar studentin me përjashtim nga provimi dhe masa të tjera përshkallëzuese.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i rezultateve, referuar rregulloreve përkatëse, është një proces që kalon nëpër disa filtra, të cilat synojnë objektivitetin, neutralitetin dhe transparencën. Në bazën dokumentare të depozituar nuk janë hedhur provime apo detyra studentësh për të konkluduar konkretisht mbi këtë aspekt. Gjithsesi, nga takimet me studentët nuk u konstatuan probleme në këtë drejtim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>e-ASCAL</i></li> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rregulloret e institucionit përmbajnë afate dhe procedura në këtë drejtim, të cilat, ndonëse në ndonjë rast nuk përputhen plotësisht me njëra-tjetrën, garantojnë një proces vlerësimi transparent dhe të korrektueshëm, nëse del e nevojshme. Takimi me studentët nuk nxorri problematika në këtë drejtim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sërish, rregulloret e institucionit tregojnë qartë rrugën që duhet të ndiqet për vlerësimin e ankesës. Në rregulloren e programit parashihet që komisioni i vlerësimit të ankesës kryesohet nga Drejtuesi i Dept., por sikurse theksuar më lart, drejtuesi i dept. është titullar në disa lëndë dhe sugjerohet që kjo pikë e rregullores të rishihet për të shmangur konfliktin e interesit në rast të ankesave potenciale për lëndët që mbulojnë nga drejtuesi. Nuk u konstatuan probleme në të këtë drejtim gjatë takimit me studentët.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për këtë program studimi nuk konstatohen problematika në procesin e vlerësimit të studentëve bazuar në meritë , sikurse edhe në transparencën e raportimit apo ankimimit të vlerësimit. Rregulloret mund të përmirësohen në këtë aspekt, për të shmangur disa mosrakordime mes tyre, por në përgjithësi janë të qarta dhe dhe të implementuara korrektësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e</p>	<p>Lëndët që përmbahen në këtë program studimi janë ato që ofrohen në shumicën e IAL-ve publike e jopublike në vend. Renditja e tyre nga viti në vit është bërë në mënyrë të tillë që</p>



<p>njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>dijet pasuese mbështeten, plotësojnë dhe zhvillojnë dijet e marra në semestrat paraardhës. Syllabuset përmbajnë informacione të bollshme në fushat që shtjellojnë dhe krahas lëndëve të profesionit, lëvrohen edhe lëndë plotësuese të tyre si: informatika, matematika, anglishtja, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Në syllabuset e depozituara konstatohen lëndë që trajtojnë çështje të teknologjisë së informacionit, komunikimit, sociale, etj. Vetë financa si fushë studimi i ka të nevojshme jo vetëm njohuritë në shkencat ekzakte, por në ato shoqërore. Gjithsesi, sot teknologjia është një faktor që vetë studentët e përdorin me përparësi për të arritur më shpejt dhe më komodë në zgjidhjen e problemeve, realizimin e detyrave, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Nga konsultimi me syllabuset e depozituara, në pothuajse secilin prej tyre, tema e fundit i dedikohet ekskluzivisht përsëritjes, pyetjeve dhe ushtrimeve për temat e zhvilluara si një formë e rishikimit dhe analizimit për përgatitjen e provimit përfundimtar. Gjithashtu syllabuset përmbajnë edhe opsionin e konsultimeve përpara provimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Nga takimet me studentët përgjatë vizitës në terren, konfirmohet se kryerja e detyrave të kursit realizohet në grupe pune, për probleme të cilat lidhen me ekonominë reale. Vetë studentët u shprehën të kënaqur për bashkëpunimin dhe mbështetjen e personelit akademik në këtë drejtim. Gjithashtu, në bazë të marrëveshjeve me institucionet bashkëpunuese, studentët i realizojnë praktikat profesionale në këto institucione, të cilat më pas reflektohen edhe në punimet e diplomës. Vetë pedagogët që lëvrojnë lëndët ushtrojnë në masë të madhe profesionin e tyre në praktikë, gjë e cila kontribuon në mësimdhënien mbi bazë kompetencash.</p>



<p>problemeve/çështjeve të caktuara; krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuarra kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vizita në subjekt</li> <li>▪ <i>Aneks 3.14 – Syllabuset e lëndëve</i></li> </ul>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Përgjatë vizitës në terren, personeli akademik konfirmoi pjesëmarrjen në syllabuset që mbulojnë të individëve nga bota e biznesit, shoqërisë civile, institucione akademike të huaja dhe të tjerë, përmes orëve të hapura. Një praktikë e tillë u konfirmua edhe nga studentët, të cilët i kishin gjetur me mjaft vlera orë të tilla leksionesh të hapura.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KUQ duket se është i angazhuar të ofrojë më të mirën e mundshme kah studentëve të vet në këtë program, për t'i kompletuar ata me dije bashkëkohore, por edhe për t'i lidhur herët me tregun e punës.</i></p> <p><i>Vetë studentët shprehen të kënaqur në këtë drejtim dhe duket se gjejnë mbështetjen e stafit akademik të institucionit në iniciativat e tyre akademike dhe praktike</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar.</p>	<p>Në dokumentacionin e depozituar gjenden rregullore të cilat prekin procesin e diplomimit dhe të provimit të përgjithshëm përfundimtar, por jo një rregullore e dedikuar ekskluzivisht për procesin e diplomimit. Në <i>Aneksin 3.0 – RVJ e programit</i>, për</p>



<p>ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>këtë kriter përmendet “<i>Aneksi 3.4.1 – Rregullore e diplomimit</i>”, por ky dokument nuk përmbahet në bazën dokumentare të depozituar në e-ASCAL. Pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome gjendet në rregulloren e njësisë bazë, neni 49 i saj, por jo në rregulloren e programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.0 – RVJ e programit</i></li> <li>▪ <i>e-ASCAL</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</b></p>	<p>Në aneksin 3.28 dhe 3.29.1 jepen një sërë informacionesh se si njësi bazë asiston studentët e këtij programi studimin në procesin e diplomimit dhe provimit të përgjithshëm. Anekset përmbajnë fushat/pyetjet orientuese, si edhe udhëzime për formatin e punimit të diplomës. Informacionet janë shteruese dhe në linjë me kërkesat rregullatorë të vetë institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.28 – Fushat e diplomës dhe temat orientuese</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.29.1 – Pyetjet e provimit të formimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</b></p>	<p>Nga të dhënat e aneksit 3.29.1, konstatohet se pyetjet e provimit final janë përfaqësuese dhe proporcionale të dijeve të marra përgjatë tre viteve, në përputhje me syllabuset e depozituara.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.29.1 – Pyetjet e provimit të formimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e</b></p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, konfirmohet se asistencja e udhëheqësit të diplomës konsiderohet optimale dhe konform rregulloreve përkatëse. Rregulloret parashohin që udhëheqësi të shprehë mendimin e tij me shkrim për punimin e diplomës, mendim i cili konsiderohet nga komisioni në momentin e vlerësimit të saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>



rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	KUQ ofron laborator informatike ku studentët mund të realizojnë përllogaritjet për punimin e tyre të diplomës. Po kështu, pedagogët, në takimin e zhvilluar me ta, u shprehën se i ndihmojnë studentët në përpunimin e pyetësorëve apo anketave të ndryshme për qëllime diplomimi. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Rregulloret shprehen qartë për vlerësimin notë dhe një fakt i tillë konfirmohet nga procesverbalet e diplomimit dhe nota në regjistrat e sekretarisë mësimore. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> </ul>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Rregulloret i parashikojnë dhe plotësojnë në detaje kërkesat e këtij kriteri. Anekset 3.17 dhe 3.17.1 ilustronjë këto dy dokumente, në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Anekset e rregulloreve</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.17 – Model i diplomës së programit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.17.1 – Model i suplementit të diplomës</i></li> </ul>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në sekretarinë mësimore, konstatohet se ruhen informacione për studentin, të cilat mund të aksesohen sipas nevojës. <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në subjekt</i></li> </ul>
<b>Konkluzione</b>	<i>Procesi i diplomimit të studentit për këtë program studimi në KUQ është i rregulluar në rregulloret përkatëse dhe ndiqet e monitorohet optimalisht nga njësia bazë, drejtuesi dhe komisioni përkatës. Nuk evidentohen problematika në këtë aspekt.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1							
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në informacionin e paraqitur në raportin e vetëvlerësimit (RVB), dokumentacionin shoqëruar të RVB-së, si dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Kolegjin Universitar Qiriazi (KUQ), GVJ konstaton se institucioni mban të dhëna mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e KUQ.  Programi i studimit Bachelor në Financë ofrohet nga Departamenti i Financës, i cili ofron edhe një program Master Shkencor në Financë. Në këtë program studimi, gjatë tre viteve të fundit akademik janë angazhuar në mësimdhënie, stafi akademik si në tabelën e mëposhtme:						
		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	Tituj/ grada	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	2	-	5	-	3	-
Prof. Asoc.	2	1	-	1	-	-	



Dr./PhD.	3	1	3	-	4	-
Msc.	2	-	3	-	3	-
<b>Totali</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>0</b>

Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin **77% nga PAE.**

Nga shqyrtimi i CV-ve të personelit akademik, GVJ konstatoi se stafi i angazhuar në këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore në fuqi për nivelin e kualifikimit (PAE dhe PAK që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi ka titujt dhe gradat sipas legjislacionit në fuqi), si dhe ka fushë kërkimore në përputhje me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara. Kolegji Universitar Qiriazi ka të angazhuar personel ndihmës akademik - 1 sekretare rektori dhe 2 sekretare mësimore. Ky staf ndihmon në përmbushjen e aktivitetit mësimor për njësinë kryesore dhe njësinë bazë, që ofrojnë këtë program studimi.

- *Aneks 3.11 - Stafit akademik që jep mësim në programin e studimit në Financë;*
- *Aneks 3.12 - CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit Financë*
- *Dokumenta shtese- 9.Tabelat për stafin (përfshijnë 3 vitet e fundit).pdf.pdf*

**Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik efektiv në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke plotësuar kushtet e kërkuara nga Ligji i Arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë. Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me personel akademik efektiv. Ngarkesa mësimore e personelit akademik në këtë program studimi, për vitin akademik 2022-2023 është:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2022-2023	960	675	285	70,3% / 29,7 %

Ngarkesa mësimore në këtë program studimi mbulohet në pjesën më të konsiderueshme të tij nga Personel Akademik Efektiv.



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.13 - Ngarkesa mësimore e pedagogëve që japin mësim në programin Financë;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.11 - Stafit akademik që jep mësim në programin e studimit në Financë</i></li> <li>▪ <i>Dok. 9 - Tabelat për stafin (përfshijnë 3 vitet e fundit)</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqëruar, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit Bachelor në Financë i ofruar nga Departamenti i Financës. Kontratat e punësimit pranë KUQ dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Në përgjithësi PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi nuk ka ndryshuar, në më shumë se <b>80% të PAE dhe PAK të angazhuar pranë Departamentit të Financës</b>, që mbulon edhe këtë program studimi.</p> <p>Për vitin akademik <b>2022-2023</b> pranë Departamentit të Financës, që mbulon këtë program studimi janë të angazhuar 11 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>7 PAE</b>, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 1 me gradën “Doktor” dhe 4 me Msc;</li> <li>▪ <b>4 PAK</b>, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 1 me gradën “Doktor”;</li> </ul> <p>Departamenti i Financës i mbulon nevojat e tij në nivelin <b>64% me PAE.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2021-2022</b> pranë Departamentit të Financës, që mbulon këtë program studimi janë të angazhuar 11 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>7 PAE</b>, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 1 me gradën “Doktor” dhe 4 me Msc;</li> <li>▪ <b>4 PAK</b>, nga të cilët 1 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asociuar” dhe 1 me gradën “Doktor”;</li> </ul> <p>Departamenti i Financës i mbulon nevojat e tij në nivelin <b>64% me PAE.</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2020-2021</b> pranë Departamentit të Financës, që mbulon këtë program studimi janë të angazhuar 9 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <b>7 PAE</b>, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 2 me gradën “Doktor” dhe 3 me Msc;</li> <li>▪ <b>2 PAK</b>, nga të cilët 1 me gradën “Doktor” dhe 1 me Msc;</li> </ul>



	<p>Departamenti i Financës i mbulon nevojat e tij në nivelin <b>78% me PAE.</b></p> <p>Të dhënat më lart dëshmojnë për qëndrueshmërinë e personelit akademik të Departamentit të Financës, i cili është njësia bazë që mbulon këtë program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.11 - Stafit akademik që jep mësim në programin e studimit në Financë;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.12 - CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4. Institucioni</b> ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB, faqen web të Kolegjit dhe në informacionin e siguruar nga vizita në institucion, GVJ konstaton se procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e KUQ që bazohet në këtë kuadër ligjor. Në statutin e KUQ janë të përcaktuara kriteret dhe procedurat që ndiqen në rekrutimin e personelit akademik (neni 30), si dhe ndihmës akademik (neni 31).</p> <p>Rekrutimi i personelit, bëhet me konkurrim të hapur. KUQ shpall konkursin për vend të lirë pune, pas kërkesës së Departamentit të Financës, bazuar në nevojat e këtij të fundit. Njësia bazë përcakton kriteret që duhet të përmbushin kandidatët bazuar në nevojat e saj dhe miratimi i tyre bëhet nga Rektori dhe nga Administratori. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit të personelit publikohen në faqen zyrtare web të KUQ. Për realizimin e procesit të rekrutimit ngrihet një komision <i>ad-hoc</i>, i përbërë nga pesë anëtarë, me shumicë nga njësia bazë. Ky proces realizohet në dy faza: faza e parë përfshin vlerësimin e dosjes së aplikantit dhe faza e dytë intervistën me gojë. Vlerësimi i kandidatit bëhet më pikë. Nëse dy kandidatë vlerësohen me të njëjtin numër pikësh, prioritet i jepet kandidatit që ka përfunduar cikël/e studimi jashtë vendit. Komisioni i përcjell Rektorit vendimin mbi kandidatin/ët e përzgjedhur. Rektori ia përcjell vendimin për miratim përfundimtar Administratorit, i cili lidh edhe kontratën e punësimit me stafin akademik.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.1 - Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.6.1 - Procedurat e emërimit të stafit akademik në KUQ;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.7.3 - Formulari i Aplikimit për staf akademik;</i></li> </ul>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton angazhimin e një numri të kufizuar personelit ndihmës akademik në funksion të këtij programi studimi. KUQ si Kolegj Universitar relativisht i vogël ka të angazhuar një personel ndihmës akademik si sekretare e rektorit dhe 2 staf të punësuar pranë sekretarisë mësimore. Stafi akademik është përgjegjës për realizimin e orëve laboratorike, si dhe në mirëmbajtjen e mjediseve mësimore. Gjatë vizitës në Institucion u konstatua se stafi akademik përgjegjës për sa më lart e konsideronte ngarkesë pune normale, në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimor, angazhimin në kujdesin për laboratorët dhe mjediset e tjera mësimore.</p> <p><i>Edhe pse KUQ është një Kolegj relativisht i vogël, <b>GVJ do të sugjeronte</b> punësimin e një stafi ndihmës akademik për Fakultetin e Ekonomisë, për të lehtësuar punën e këtij Fakulteti dhe Departamenteve përkatëse.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.10 - Stafi akademik i Departamentit të Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjisllacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe atij të marrë gjatë vizitës në KUQ, GVJ konkludon se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bachelor në Financë, është Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivit (ZBNJPA). ZBNJPA funksionon bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Ligji Nr. 80, datë 22.07. 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe Statuti dhe Rregullorja e KUQ.</p> <p>Gjatë vizitës pranë kësaj strukture, GVJ konstatoi se ZBNJPA mban të dhëna në formën e dosjeve personale (format letër) për të gjithë personelin me kohë të plotë ose me kontratë dhe si rregull bën përditësimin e tyre mbi bazë vjetore. Nga verifikimi me zgjedhje i dy dosjeve personale pranë sektorit të Burimeve Njerëzore, përkatësisht një PAE dhe një PAK, GVJ konstatoi përmbajtjen e dosjes së personelit akademik: kontratë individuale; formular aplikimi, CV, diploma (bachelor, master, etj., si dhe listat e notave shoqëruese); dëshminë e penaltetit; raport mjekësor; çertifikatë mbrojtje e gjuhës së huaj, si edhe dokumente të tjerë plotësues, kryesisht të lidhura me kualifikime shkencore dhe akademike.</p> <p><i>GVJ konstaton se Institucioni ka të nevojshme një sistemim më të mirë të dosjeve të personelit akademik, të përditësimit të dokumenteve, si dhe mbajtjen e tyre jo vetëm në formatin fizik,</i></p>

	<p>por edhe në formatin on-line, që informacioni të jetë si transparent, ashtu edhe lehtësisht i aksesueshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Aneks 1.1 - Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021;</li> <li>▪ Aneks 1.3 - Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi_2022;</li> <li>▪ Aneks 1.7.2 - Kontratë pune me stafin e KUQ;</li> <li>▪ Aneks 2.8 - Lista e dokumenteve në dosjen e personelit</li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>KUQ në nivel Institucional ka nënshkruar një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private, në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe në kuadër të realizimit të praktikës mësimore të studentëve dhe mundësitë për punësim të tyre. Programi i studimit Bachelor në Financë ka pjesë të programit mësimor realizimin e praktikës mësimore me kohëzgjatje 5 javë, gjatë semestrit të dytë, të vitit të tretë akademik. Numri i vogël i studentëve që frekuentojnë këtë program studimi, nuk i krijon institucionit asnjë problem për realizimin e praktikave mësimore. Nëse studentët nuk sigurojnë vetë një Institucion për të zhvilluar praktikën mësimore, atëherë zyra e Karrierës dhe Alumni ua mundëson praktikën pranë një Institucioni me të cilin kanë lidhur marrëveshje.</p> <p>Studentët të këtij program studimi marrin informacion në lidhje me mundësitë për realizimin e praktikave mësimore, kryesisht nëpërmjet lajmërimeve në website-in e KUQ, rrjeteve sociale, por edhe eventeve të tjera të organizuara si: panairi i karrierës/punës (work and study), leksione të hapura, workshop-e, trajnime, etj. Gjithashtu gjatë takimit me studentët, doli në pah që informacione në lidhje me mundësinë për zhvillimin e praktikave mësimore iu ofrohen si nga zyra e karrierës, ashtu edhe nga pedagogët që zhvillojnë mësim në këtë program. Vlen për tu përmendur që nga takimi me studentët doli në pah se zyra e karrierës pranë KUQ prej dy vitesh u ofronte studentëve mundësinë për të realizuar praktika profesionale jashtë vendit, si dhe punësim sezonal në verë jashtë vendit, gjë që i ndihmonte ata për të përballuar edhe një pjesë të kostos së shkollimit.</p> <p>Departamenti i Financës cakton një staf akademik përgjegjës për mbarëvajtjen e studentit gjatë praktikës mësimore. Gjithashtu në vendin ku zhvillohet praktika, studentit i caktohet një person mbikëqyrës për realizimin me sukses të praktikës profesionale. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi është i angazhuar për të asistuar studentët që klasifikohen për të përgatitur punim diplome, në</p>



	<p>drejtimin dhe mbikëqyrjen e tyre gjatë gjithë periudhës së përgatitjes, në zbatim të nenit 21 të Rregullores së programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.18 - Lista e marrëveshjeve në funksion të programit Financë;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.8 - Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit, brenda dhe jashtë vendit;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.19 - Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit të Financës;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.4 - Rregullore e programit të studimit të Financës;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.16 - Rregullore e praktikës profesionale;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.9 - Programi mësimor i Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</b></p>	<p>Në Institucionin ku zhvillohet praktika, studentit i caktohet një person mbikëqyrës për realizimin me sukses të praktikës profesionale, krahas përcaktimit nga Departamenti i Financës së një stafi akademik që do të ndjekë studentin gjatë gjithë periudhës së realizimit të praktikës.</p> <p>Mbikëqyrësi, në institucionin e zhvillimit të praktikës dhe në fund të këtij procesi, realizon edhe një vlerësim mbi punën e studentit. Gjithashtu në fund të praktikës përpilohen dokumentet në përputhje me Rregulloren e praktikës profesionale, si dhe formatit të dosjes së praktikës profesionale.</p> <p>Si pedagogu mbikëqyrës, ashtu edhe mbikëqyrësi në Institucion angazhohen në rritjen e nivelit profesional të studentëve dhe në përfundim të praktikës bëjnë vlerësimin me pikë të studentëve. Në përfundim të praktikës mësimore, studenti vlerësohet me simbolet fiton/nuk fiton.</p> <p><b><i><u>GVJ sugjeron</u> vlerësimin me notë të studentit në praktikën mësimore, pasi njohuritë e përfituara të studentëve gjatë praktikës ndikojnë në ngritjen profesionale të tij, duke ndikuar në formimin e tij, gjë që duhet të reflektohet edhe në vlerësimin e përgjithshëm të studentit. Gjithashtu duke qenë se praktika profesionale në programin mësimor vlerësohet me një numër të konsiderueshëm kreditesh (8 ECTS), nënkupton që mesatarja e ponderuar e studentit deformohet, duke mos konsideruar këto kredite në numrin total të krediteve.</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.16 - Rregullore e praktikës profesionale;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.15 - Model i dosjes së praktikës profesionale;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.7 - Dosja e programit të studimit BACHFI</i></li> </ul>



<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në këtë program studimi, plotësojnë kushtet e kërkuara nga Ligji i arsimit të Lartë për të dhënë mësim në IAL si dhe kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe profesional për natyrën dhe modulet e këtij programi.</i></li> <li>- <i>Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me PAE. Stafi i angazhuar në këtë program studimi është përgjithësisht i qëndrueshëm, referuar si PAE, ashtu edhe PAK.</i></li> <li>- <i>Institucioni ndjek procedurat e duhura të rekrutimit të stafit akademik dhe ndihmës akademik, duke përcaktuar kritere specifike në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij program studimi.</i></li> <li>- <i>Institucioni ka nënshkruar një numër marrëveshesh bashkëpunimi me institucione publike dhe private. Zyra e karrierës dhe ALUMNI, si dhe stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, mundësojnë zhvillimin e praktikës mësimore profesionale, duke u siguruar që mbikëqyrësi në vendin e praktikës të angazhohet në rritjen e nivelit profesional të studentit. Studentëve të këtij programi studimi u është ofruar mundësia për të zhvilluar edhe praktika profesionale jashtë vendit, si dhe mundësi sezonale punësimi.</i></li> </ul> <p><i>Edhe pse KUQ është një Institucion relativisht i vogël, GVJ sugjeron punësimin e një stafi ndihmës akademik për Fakultetin e Ekonomisë, për të lehtësuar punën e këtij fakulteti dhe departamenteve përkatëse.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron sistemimin e dosjeve të personelit akademik, përditësimin e dokumenteve, si dhe mbajtjen e tyre jo vetëm në formatin fizik, por edhe në formatin on-line, që informacioni të jetë si transparent, ashtu edhe lehtësisht i aksesueshëm.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron vlerësimin me notë të studentit në praktikën mësimore, pasi njohuritë e përfituara të studentëve gjatë praktikës ndikojnë në ngritjen profesionale dhe vlerësimin e përgjithshëm të tij.</i></p>			
	<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X	

**Standardi IV.2**



**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Referuar RVB-së, dokumentacionit shoqërues si dhe vizitës në Institucion KUQ zhvillon procesin mësimor në një godinë 3-katëshe në brendësi të Kampusit Universitar të Universitetit Bujqësor të Tiranës, në Kodër Kamëz. Ambjenti ku zhvillohet procesi mësimor është në një zonë të gjelbër dhe shplohëse për studentët dhe stafin e këtij Institucioni. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi ambjente të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtaritë mësimore të programit Bachelor në Financë, duke konsideruar kurrikulën, numrin e grupeve dhe numrin e studentëve. Për të mundësuar këtë program studimi, Fakulteti i Ekonomisë ka në dispozicion 7,8 m<sup>2</sup>/ student. Këto sipërfaqe konsistojnë në salla leksioni, salla seminari, sallë për aktivitete promovuese, 1 laborator informatike, sallë Interneti, sallë biblioteke, mjedis sportiv, si dhe mjedis shplohës kafe/ ushqim i shpejtë. Gjithashtu në këtë godinë ndodhen edhe zyrat për stafin drejtues, personelin akademik dhe ndihmës akademik. Zyrat dhe auditorët kanë lartësi 3-3,5 m duke mundësuar ndriçim të plotë për studentët dhe stafin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.14.2 - Infrastruktura mësimore e KUQ;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në Institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisur me kompjuter dhe projektor të fiksuar, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, duke iu lehtësuar pedagogëve dhe studentëve procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në takimin me studentë u evidentua mundësia e përdorimit të sallave të laboratorëve edhe gjatë procesit të realizimit të diplomës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.14.2 - Infrastruktura mësimore e KUQ;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi që mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë</p>





<p>mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>së lartë. Sallat ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me kompjuter dhe projektor të fiksuar, ndërkohë që laboratorët janë të pajisur me kompjutera, ku janë instaluar programet Alfa, E-views, SPSS që ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve, duke plotësuar edhe objektivat kryesore të këtij program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.14.2 - Infrastruktura mësimore e KUQ;</i></li> </ul>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Ky institucion ofron mundësinë e përdorimit të 1 laboratorit informatike dhe 1 salle Interneti, të pajisur me kompjutera ku janë instaluar programet Alfa, E-views dhe SPSS që ndihmojnë në aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.14.2 - Infrastruktura mësimore e KUQ;</i></li> </ul>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e këtij programi studimi.</i></li> <li>- <i>Infrastruktura e godinës, mjediset e gjelbra që e rrethojnë dhe vendndodhja në një kampus universitar ofrojnë një ambient shumë bashkëkohor për studentët e këtij programi studimi.</i></li> <li>- <i>Mjediset mësimore janë të pajisura me mjete të teknologjisë së lartë në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies në këtë program.</i></li> <li>- <i>Laboratori i informatikës është i pajisur me programe dhe software të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.</i></li> </ul>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi IV.3**

**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Referuar dokumenteve shoqëruese të RVB, GVJ konstaton që për të gjitha lëndët e këtij programi vihet në dispozicion të studentëve literaturë bazë në gjuhën e programit, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj. Literatura, kryesisht ajo në gjuhën shqip, por edhe në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze) ofrohet në formë fizike dhe digjitale (CD dhe DVD) pranë bibliotekës së këtij Institucioni.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Financë</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.15 - Lista e librave të reja sipas programeve BCH në FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.22 - Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ, referuar dokumentacionit shoqërues të RVB si dhe vizitës në Institucion, konkludon se literatura bazë përditësohet rregullisht me botime të viteve të fundit. GVJ konstaton se ky përditësim nuk bëhet rregullisht për literaturën ndihmëse. Në bibliotekë, numri i librave fizikë që shërbejnë si literaturë ndihmëse është relativisht i kufizuar dhe kryesisht me vite të hershme botimi.</p> <p>Praktika në këtë Institucion është që në fillim të vitit të bëhen kërkesa për blerje titujsh fizikë librash, të cilat kryesisht konsistojnë në libra që shërbejnë si literaturë bazë në shqip për këtë program studimi. Ndërkohë në bibliotekë mbahen të shkarkuar në CD e DVD libra të ndryshëm në literaturë të huaj. Biblioteka nuk mund të aksesohet online në këtë Institucion. Nuk ka platformë elektronike ku Institucioni të jetë regjistruar për të marrë shërbimin si bibliotekë online.</p> <p><b><u>GVJ sugjeron</u></b> shtimin e titujve fizikë në bibliotekë - botime të viteve të fundit - në shqip dhe në gjuhë të huaj që të shërbejnë si literaturë ndihmëse për këtë program studimi.</p> <p><i>Gjithashtu sugjerohet bërja pjesë e platformave elektronike (biblioteka online) pasi këto ofrojnë mundësinë për përditësim të literaturës digjitale për studentët.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.14 - Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Financë</i></li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 2.15 - Lista e librave të reja sipas programeve BCH në FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.22 - Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se KUQ vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar në këtë program studimi, bibliotekën e cila ndodhet në katin e dytë të Godinës. Salla e bibliotekës është e pajisur me poste me kompjuter, si dhe me poste të tjera për të studiuar në të. Salla është e ndriçuar shumë mirë, duke përbushur kushtet e studimit në të. Të gjithë studentët e këtij program studimi kanë akses të njëjtë për të përdorur bibliotekën dhe literaturën e ofruar në të, që konsiston në libra fizikë, si edhe CD dhe DVD.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë dhe informacioni i marrë rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të Fakultetit të Ekonomisë si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste ndihmëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj; e cila mund të shfrytëzohet njëjloj nga të gjithë studentët dhe stafi akademik. Megjithatë kjo literaturë ndihmëse është e kufizuar, jo shumë e përditësuar dhe ka një numër të vogël revistash dhe publikimesh shkencore (kryesisht vetëm ato nga Akademia e Shkencave në Shqipëri). <u><i>GVJ sugjeron</i></u> që në literaturën fizike të bibliotekës nevojitet një investim më i madh.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.15 - Lista e librave të reja sipas programeve BCH në FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.22 - Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se studentët kanë mundësi të barabartë të aksesojnë libra apo botime të tjera sipas fushës së interesit, si dhe moduleve të këtij programi studimi, kryesisht në trajtën e literaturës fizike në bibliotekë si dhe në materialet e shkarkuara që ofrohen me CD dhe DVD.</p> <p><u><i>GVJ sugjeron</i></u> regjistrimin e Institucionit në platforma elektronike (biblioteka online) për ti dhënë akses studentëve në</p>



	<p><i>literaturën e domosdoshme dhe të përditësuar, gjë që do të ndikonte në rritjen e cilësisë së këtij program studimi.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.15 - Lista e librave të reja sipas programeve BCH në FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.22 - Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit Financë</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës që i shërben programeve që ofron ky Institucion. Në njërin kënd të bibliotekës ishte përqendruar edhe literatura në funksion të Fakultetit të Ekonomisë, pra edhe të këtij program studimi. Salla e bibliotekës ka Internet dhe është e pajisur me poste me kompjutera dhe me poste fizikë për të studiuar. GVJ-së iu konfirmua nga punonjësi i bibliotekës dhe studentët, se biblioteka frekuentohej nga studentët, kryesisht për të tërhequr libra apo materiale mësimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka ofron shërbime për studentët në orare që përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, për këtë program studimi. Për t'u ardhur në ndihmë studentëve, biblioteka ofron shërbim me orar të kufizuar edhe ditën e shtunë. Orari i bibliotekës, 8:00-17:00 nga e Hëna në të Premte është i afishuar në ambientet e institucionit. Të dhëna për bibliotekën janë të publikuar edhe në website-n e KUQ.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> <li>▪ <i><a href="https://qiriaz.edu.al/">https://qiriaz.edu.al/</a></i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit,</p>	<p>Referuar RVB, dhe dokumentacionit shoqërues, GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik, pedagogët e angazhuar në këtë program studimi bëjnë kërkesa për blerje literature fizike për bibliotekën. Në planin financiar të Institucionit nuk janë të evidentuar veçant shpenzimet që janë kryer për investimet në literaturën e bibliotekës, por nga dokumentet shoqërues dhe gjatë vizitës në institucion na u konfirmua që blihen literaturë kryesore që ofrohet për modulin/lëndën. Ndërkohë pjesë e Planit Strategjik të KUQ është edhe pasurimi i bibliotekës.</p> <p><b><u>GVJ sugjeron</u> që në kuadër të këtij plani strategjik të pasurohet biblioteka me tituj fizikë të përditësuar në shqip dhe gjuhë të huaj, si dhe të vihet një fokus themelor në regjistrimin</b></p>



<p>shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p><i>në biblioteka online për një akses më komod dhe me shumë përfitim për studentët.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 2.15 - Lista e librave të reja sipas programeve BCH në FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.22 - Lista dhe kërkesa e pasurimit të teksteve në bibliotekë në funksion të programit Financë</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.21 - Plani i financimit të programit të studimit Financë</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.2 - Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve literaturë bazë në gjuhën e programit, si dhe literaturë ndihmëse në gjuhën e programit dhe në gjuhë të huaj për modulet/ lëndët e këtij program studimi.</i></li> <li>- <i>Biblioteka fizike dhe mundësia për të aksesuar CD dhe DVD vihet në dispozicion të të gjithë studentëve në mënyrë të barabartë, pa pagesë dhe në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor për këtë program studimi. Institucioni ka mundësuar ofrimin e këtij shërbimi edhe në fundjavë.</i></li> <li>- <i>Salla e bibliotekës ka Internet dhe është e pajisur me poste me kompjutera dhe poste fizikë për të studiuar.</i></li> <li>- <i>Përditësimi i literaturës bazë bëhet rregullisht, ndërkohë që përditësimi i literaturës ndihmëse është i kufizuar.</i></li> </ul> <p><i>GVJ sugjeron shtimin e titujve fizikë të përditësuar në bibliotekë, veçanërisht për literaturën ndihmëse dhe për publikime shkencore.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron regjistrimin/ abonimin në biblioteka online ku studentët dhe stafi akademik të kenë akses. Kjo do të ndikojë në rritjen e cilësisë së këtij program studimi dhe të kërkimit shkencor të Institucionit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi IV.4**




<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ky Institucion disponon një sistem menaxhimi të brendshëm (SMI) të ndërtuar nga stafi i këtij Institucioni, dhe që monitoron, administron dhe informon në funksion të veprimtarisë akademike. Informacioni për studentët mbahet nga sekretaria mësimore në trajtë <i>soft copy</i> (në MS Excel) dhe në trajtë <i>hard copy</i> (në regjistra). Sekretaria mësimore është struktura që administron të gjithë informacionin lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim për këtë program studimi.</p> <p><b>Gjatë vizitës në sekretari GVJ-ja evidentoi disa parregullsi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesë të regjistrimit të diplomimit;</li> <li>- Korrigjime me korrektor të numrit të matricullimit të studentëve;</li> <li>- Në disa raste në regjistër u evidentua mungesë e numrit të matricullimit dhe evidentim me një kod tjetër, ndërkohë që në kompjuter ishin të hedhur numrat e matricullimit edhe për këta studentë, njëlloj si për të tjerët;</li> <li>- Mungesë hedhje note në regjistrin fizik, ndërkohë që nota ishte hedhur në procesverbal, dhe në regjistrin elektronik.</li> </ul> <p>Punonjëset e sekretarisë ishin staf relativisht i ri në punë, duke ndikuar në këtë mënyrë në mos sqarimin e të gjitha problematikave më lart. Sekretaria kishte 3 muaj që kishte filluar procesin e rakordimit të të dhënave ndërmjet procesverbaleve, regjistrave elektronike dhe regjistrave fizikë, në mënyrë që të shmangen të gjithë problematikat e krijuara. Për këtë ishte punësuar edhe një asistente në sekretari përpara 1 muaji nga momenti i vizitës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.10 - Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.4 - Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës-akademik,</p>	<p>Duke iu referuar dokumentacionit të dorëzuar, Rregullores së KUQ dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se administrimi i informacionit për personelin e angazhuar në programin e studimit Bachelor në Financë realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës në formën e dosjes personale të personelit, si dhe</p>

<p>personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>mbajtjen e të dhënave edhe në trajtë elektronike (në MS Excel).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.3 - Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi 2022;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.7.2 - Kontratë pune me stafin e KUQ;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 2.8 - Lista e dokumenteve në dosjen e personelit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga Institucioni dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në KUQ, GVJ-ja konstatoi se nuk ka një platformë elektronike të dedikuar që t'u sigurojë akses të gjithë të interesuarve në këtë program studimi, veçanërisht studentëve dhe stafit akademik. Aktualisht shkëmbimi i informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, përveç komunikimit fizik në auditorë, realizohet edhe nëpërmjet platformave online: Google Classroom apo të ngjashme, si dhe adresave elektronike të e-mailit. Komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale është një formë tjetër interaktive në funksion të lehtësimit të këtij programi studimi.</p> <p>Nëpërmjet këtyre kanaleve bëhet i mundur ofrimi i materialeve shtesë për studentët, slides për leksionet, rastet studimore, si dhe informacione nga Zyra e Karrierës dhe Alumnit. Palët e interesuara gjejnë akses edhe në faqen web të KUQ, si edhe në stendat fizike në Institucion.</p> <p><b><i>GVJ sugjeron</i></b> ngritjen e një platforme elektronike të dedikuar për studentët, personelin akademik dhe jo-akademik. Duhet të mundësohet përdorimi i platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, lista e notave dhe krediteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.3 - Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi 2022;</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3. 4 - Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ-ja konstaton se Institucioni nuk ka një platformë për të ofruar akses të dedikuar për studentët, stafin akademik dhe jo-akademik. Përdorimi i platformave online (Google Classroom) nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi ofron mundësi më të mëdha për një komunikim interaktiv me studentët, si edhe shkëmbim informacioni, ofrim materialesh, si dhe realizimin e Quizz-ve, Assignments në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.23 - Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se ky sistem i menaxhimit të brendshëm (SMI) i ndërtuar nga stafi akademik i këtij Institucioni që monitoron, administron dhe informon në funksion të veprimtarisë akademike, mundëson raportime në kohë reale për studentët, stafin akademik dhe jo-akademik, te autoritetet drejtuese të Institucionit, sipas hierarkisë përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Pas konsultimit të website të KUQ, GVJ konstaton se janë bërë publike informacione që lidhen me programin e studimit, njësinë bazë që ofron programin e studimit, stafin akademik, si dhe një sërë informacione dhe aktivitete të tjera. Ato publikohen në faqen e Internetit në gjuhën shqip, dhe në gjuhën anglisht. GVJ konstaton që, referuar mënyrës së organizimit të rubrikave në këtë website, informacioni në faqen e web-it është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i><a href="https://qiriaz.edu.al/">https://qiriaz.edu.al/</a></i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni disponon sistem menaxhimi të brendshëm (SMI) të ndërtuar nga stafi i këtij institucioni që monitoron, administron dhe informon në funksion të veprimtarisë akademike.</i></li> <li>- <i>Informacioni në website-in e KUQ publikohet në dy gjuhë (shqip dhe anglisht) dhe ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm.</i></li> </ul> <p><i>GVJ pas konstatimit të një sërë problematikash në zyrën e sekretarisë mësimore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Mungesë të regjistrimit të diplomimit;</i></li> <li>- <i>Korrigjime me korrektor të numrit të matrikullimit të studentëve;</i></li> <li>- <i>Në disa raste në regjistër u evidentua mungesë e numrit të matrikullimit dhe evidentim me një kod tjetër, ndërkohë që në kompjuter ishin të hedhur numrat e matrikullimit edhe për këta student, njëlloj si për të tjerët;</i></li> <li>- <i>Mungesë hedhje note në regjistër fizik, ndërkohë që nota ishte hedhur në procesverbal, dhe në regjistrin elektronik.</i></li> </ul>





	<p><i>sugjeron kontrollin check and balance: procesverbal, regjistër fizik (të tre regjistrat bazuar në legjislacionin në fuqi) dhe regjistër elektronik, për këtë program studimi. Nga sekretaria në këtë institucion na u konfirmua që kjo ishte puna me të cilën po merreshin aktualisht.</i></p> <p><b><i>GVJ sugjeron</i></b> ngritjen e një platforme elektronike të dedikuar për studentët, personelin akademik dhe jo-akademik. Duhet të mundësohet përdorimi i platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, lista e notave dhe krediteve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit. Në statutin e KUQ përcaktohet që KUQ është një IAL jo-publik me vetë-financim. GVJ, mbështetur në dokumentet shoqëruese të RVB dhe vizitën në Institucion, konstatoi se KUQ harton planin financiar të të ardhurave dhe kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit akademik dhe kërkimor të këtij Institucioni mbështetet financiarisht nga grupi i bizneseve të lidhura me të. Në kuadër të qëndrueshmërisë financiare, Bordi i Administrimit në bashkëpunim me Senatën Akademik kanë hartuar një plan të përbashkët buxhetor për periudhën 2018-2025.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.1 - Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.21 - Plani i financimit të programit të studimit Financë</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.21.1 - Plani i financimit të programit të studimit Financë, 2021-2022</i></li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.21.1 - Plani i financimit të programit të studimit Financë, 2022-2023</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.14.1 - Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ konstaton se, në raportet financiare, shpenzimet janë të klasifikuara kryesisht sipas natyrës së tyre në terma të gjerë, ndërsa të ardhurat janë parashikuar duke iu referuar numrit të studentëve për çdo njësi bazë sipas programeve të studimeve që ofrojnë. <b><u>GVJ sugjeron që analiza e shpenzimeve, pjesë e planit financiar, të jetë më e detajuar (p.sh. fondi për librat e rinj, fondi për abonime në revista online, fondi për platformë të re online, fondi për investime në pajisje të reja didaktike, etj).</u></b></p> <p>Institucioni ka akorduar një fond prej 8.000 euro për çdo njësi bazë në kuadër të rritjes së nivelit të kërkimit shkencor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 3.21.1 - Plani i financimit të programit të studimit Financë, 2022-2023</i></li> <li>▪ <i>Aneks 1.14.1 - Plani buxhetor (2018-2025), për menaxhimin me efektivitet të institucionit</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.26 - Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor, miratuar me vendim Bordi</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>GVJ, mbështetur në dokumentet shoqëruese të RVB dhe vizitën në Institucion, konstaton se KUQ, në bazë të Ligjit nr. 10091, dt. 05.03.2009 për Auditimin Ligjor, nuk është Institucion që i nënshtrohet auditimit të jashtëm. Megjithatë, KUQ kryen kontroll financiar të brendshëm, kryesisht në funksion të analizës së qëndrueshmërisë financiare të Institucionit që realizohet nga Bordi i Administrimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks 1.1 - Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021</i></li> <li>▪ <i>Aneks 3.21.1 - Plani i financimit të programit të studimit Financë, 2022-2023</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit</p>	<p>GVJ, mbështetur në RVB, konstaton se KUQ në kuadër të detyrimit për raportim vjetor në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në një aneks të veçantë raporton nga pikëpamja financiare në lidhje me realizimin e të ardhurave dhe</p>



të miratuar të vitit paraardhës.	shpenzimeve, plotësimin e nevojave për bazën didaktike dhe literaturën e nevojshme.  ▪ <i>Aneks 1.21 - Shkresa nr. 210, dt. 28.12.2022 e KUQ për MAS, dërgim raporti vjetor</i>															
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>KUQ harton planin financiar të të ardhurave dhe kostove të njësisë bazë, përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit akademik dhe kërkimor të këtij Institucioni mbështetet financiarisht nga grupi i bizneseve të lidhura me të. Në kuadër të qëndrueshmërisë financiare, Bordi i Administrimit në bashkëpunim me Senatën Akademik kanë hartuar një plan të përbashkët buxhetor për periudhën 2018-2025. Duke qenë se të gjithë analizat janë mbi bazë institucioni dhe njësisë bazë, <b><u>GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare të veçantë për këtë program studimi, duke konsideruar numrin të studentëve:</u></b></p> <table border="1" data-bbox="608 931 1321 1167"> <thead> <tr> <th></th> <th>2019- '20</th> <th>2020- '21</th> <th>2021- '22</th> <th>2022- '23</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>Të regjistruar Viti I</i></td> <td>10</td> <td>6</td> <td>6</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td><i>Studentë gjithsej</i></td> <td></td> <td>32</td> <td>25</td> <td>27</td> </tr> </tbody> </table> <p>▪ <i>Aneks 3.21.1 - Plani i financimit të programit të studimit Financë, 2022-2023</i>          ▪ <i>Aneks 2.9 - Numri studentëve të regjistruar në vite në FE</i>          ▪ <i>Dok. 13 - Numri studenteve të regjistruar dhe të transferuar në program studimi</i></p>		2019- '20	2020- '21	2021- '22	2022- '23	<i>Të regjistruar Viti I</i>	10	6	6	8	<i>Studentë gjithsej</i>		32	25	27
	2019- '20	2020- '21	2021- '22	2022- '23												
<i>Të regjistruar Viti I</i>	10	6	6	8												
<i>Studentë gjithsej</i>		32	25	27												
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><b>GVJ konstaton:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>KUQ harton planin financiar të të ardhurave dhe kostove të njësisë bazë, përgjegjëse për programet e studimit që ofron ky institucion. Një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit akademik dhe kërkimor të këtij Institucioni mbështetet financiarisht nga grupi i bizneseve të lidhura me të.</i></li> <li>- <i>Në kuadër të qëndrueshmërisë financiare Bordi i Administrimit në bashkëpunim me Senatën Akademik kanë hartuar një plan të përbashkët buxhetor për periudhën 2018-2025.</i></li> <li>- <i>KUQ nuk është Institucion që duhet t'i nënshtrohet auditimit ligjor të jashtëm, megjithatë kryen kontroll financiar të brendshëm,</i></li> </ul>															



	<p>- kryesisht në funksion të analizës së qëndrueshmërisë financiare.</p> <p><i>GVJ sugjeron që analiza e shpenzimeve pjesë e planit financiar të jetë më e detajuar.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron kryerjen e një analize qëndrueshmërie financiare të veçantë për këtë program studimi, duke konsideruar numrin total të studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion dhe nga konsultimi i faqes web të KUQ, GVJ konkludon se politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1 Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3 Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi 2022</i></li> <li>▪ <i>An. 2_3 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2 Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_4 Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> </ul>

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Barazia e të drejtave për kandidatët dhe studentët e programit të studimit garantohet nga statuti i KUQ, rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, rregullore e Departamentit të Financës dhe rregullore e Programit të Studimit Bsc në Financë. Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar që pranohen në këtë program studimi kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe provimet e detyrueshme të maturës shtetërore, si dhe të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me VKM, ose kandidatë që kanë një diplomë universitare për program të dytë studimi, sipas Udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara nga MASR. Kriteret e përzgjedhjes bëhen publike nga vetë institucioni.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi 2022</i></li> <li>▪ <i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Financës, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi përcakton kuotat e pranimit, kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për këtë cikël studimesh, dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe standardet shtetërore të cilësisë. Në rregullore parashikohet edhe regjistrimi i studentëve të huaj, apo ata që kanë një diplomë të shkollës së mesme në gjuhë të huaj, pasi kjo e fundit të jetë ekuivalentuar nga komisioni përkatës pranë MAS.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi 2022</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>An. 1_17_Kriteret e pranimit të studentëve në " Kolegjin Universitar Qiriazi", për vitin akademik 2023-2024</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, si dhe konsultimit të faqes web të KUQ, GVJ konstaton se kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të aksesueshme nga publiku:</p>



<p>ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në sekretarinë mësimore të KUQ;</li> <li>- Afishimit të informacionit në stenda në ambientet e Institucionit;</li> <li>- Faqen web të KUQ;</li> <li>- Departamentin e Financës- Fakulteti i Ekonomisë.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></li> <li>▪ <i>An. 1_17_Kriteret e pranimit të studentëve në " Kolegjin Universitar Qiriazhi", për vitin akademik 2023-2024</i></li> <li>▪ <i>Vizita në institucion;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Informimi i të gjithë të interesuarve në lidhje me KUQ, programet e studimit dhe kriteret e pranimit në to, realizohet nëpërmjet fushatës sensibilizuese për tërheqjen e kandidatëve për studentë në këtë program studimi. Zakonisht kjo fushatë konsiston në takimet e programuara me maturantë në gjimnaze publike dhe private në vend. Këto takime programohen dhe realizohen në rang Institucioni. Gjithashtu Institucioni zhvillon një fushatë të gjerë sensibilizuese online nëpërmjet rrjeteve sociale, medias, etj. Informacioni që ofrohet gjatë fushatës sensibilizuese është edhe i publikuar në faqen web të KUQ.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></li> <li>▪ <i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Mardhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë</i></li> <li>▪ <i>An. 1_17_Kriteret e pranimit të studentëve në " Kolegjin Universitar Qiriazhi", për vitin akademik 2023-2024</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ konstaton se në statutin e KUQ nuk është përcaktuar që njësitë bazë të hartojnë dhe publikojnë përpara çdo viti akademik kuota specifike për personat me aftësi të veçanta.</p> <p>Megjithatë në këtë statut është e përcaktuar se pranimi i studentëve bëhet sipas përcaktimeve të kuadrut ligjor në fuqi, në përputhje me standardet shtetërore. Gjithashtu në RVB, Institucioni deklaron që çdo vit Senati në bashkëpunim me Bordin e Administrimit miraton kuotat në varësi të kapaciteteve infrastrukturore që ka, dhe këto ia dërgon për miratim MAS, ku janë të parashikuara kuotat për individët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Institucioni ka të përfshirë në kodin e etikës mospranimin e asnjë lloj diskriminimi të ndryshueshmërisë ndërmjet individëve. <i>Sugjerohet shtimi i përfshirjes së mënyrës së trajtimit të kandidatëve me aftësi të veçanta dhe shtresave të</i></p>



	<p><i>margjinalizuara në Statutin e KUQ, ose në rregulloret e institucionit dhe njësive përkatëse.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An._1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021;</i></li> <li>▪ <i>An._1_5_Rregullore e Këshillit të Etikës;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstanton se në rregulloren e Institucionit parashikohet edhe regjistrimi i studentëve të huaj, apo ata që kanë një diplomë të shkollës së mesme në gjuhë të huaj, pasi kjo e fundit të jetë ekuivalentuar nga komisioni përkatës pranë MAS.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An._1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi 2022</i></li> <li>▪ <i>Aneks._3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>An._1_17_Kriteret e pranimit të studentëve në “ Kolegjin Universitar Qiriazhi”, për vitin akademik 2023-2024</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Referuar RVB, dokumentacionit shoqërues dhe vizitës në Institucion GVJ konstaton se KUQ ofron bursë të pjesshme për studentë me mesatare të lartë mbi 8 dhe bursë të plotë për studentë ekselentë. Këto janë masa që merren për të tërhequr studentë me mesatare të lartë, në mënyrë që edhe programi i studimit të bëhet sa më tërheqës dhe cilësor. Ndërkohë Institucioni ofron edhe bursë për studentë me situatë ekonomike të vështirë. Gjithashtu, Institucioni ofron mundësinë e pagesës së kostos vjetore të studimit me këste mujore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An._1_15_Vendimi i Bordit Administrativ për tarifa dhe bursa_VF</i></li> <li>▪ <i><a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></i></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstantoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve janë në përputhje me legjislationin në fuqi dhe aktet e tjera rregullatore.</i></li> <li>- <i>Institucioni bën publike kriteret dhe procedurat e pranimit në programin e studimit duke garantuar akses në informacion dhe barazi në procesin e pranimit të aplikimeve dhe të përzgjedhjes për të gjithë kandidatët.</i></li> <li>- <i>Institucioni ofron bursë për studentët nga shtresat në nevojë, si dhe për studentë që përmbyllin studimet e shkollës së mesme me mesatare të lartë.</i></li> </ul>

	<i>GVJ sugjeron përfshirjen e mënyrës së trajtimit të kandidatëve me aftësi të veçanta dhe shtresave të marginalizuara në Statutin e KUQ, ose në rregulloret e institucionit dhe njërive përkatëse</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion dhe të paraqitur në faqen zyrtare web të KUQ, GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve vihet informacion i plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. Këto kritere dhe procedura janë pjesë e Rregullores së KUQ, rregullores së Fakultetit të Ekonomisë, rregullores së Departamentit të Financës dhe veçanërisht të Rregullores së programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi_2022</i></li> <li>▪ <i>An. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Referuar Rregullores së programit të studimit dhe rregullores së Departamentit të Financës, GVJ konstaton se studentit i ofrohet mundësia për njohjen e krediteve dhe transferim të studimeve, midis programeve në fusha të njëjta ose të ngjashme, si brenda institucionit ashtu edhe nga institucione të tjera publike dhe jo publike të arsimit të lartë, brenda vendit dhe jashtë tij, vetëm në fillim të vitit akademik, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015.</p> <p>Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e Departamentit të Financës. Procesi i njohjes së krediteve dhe vlerësimit të</p>



	<p>kurrikulës bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. Kreditet minimale të domosdoshme për transferimin e studimeve janë 30 kredite të fituara. Gjatë vizitës në Institucion, në sekretarinë mësimore u kërkua dosja e një studenti të transferuar të zgjedhur nga GVJ në mënyrë rastësore dhe dosja rezultoi e plotë, si dhe ishin ndërmarrë të gjithë hapat e përmendur më sipër gjatë procedurës së transferimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>8.Model vendimi transferimi</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konkludon që studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit dhe Rregullores së Departamentit të Financës. Në javën e parë të fillimit të procesit mësimor, e njohur si “Java Informuese” për secilën lëndë, studentëve ju ofrohet informacion nga pedagogu për syllabusin e lëndës, detyrimet për tu përmbushur, si edhe mënyrën e vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor të lëndës vlerësohet me një sistem pikëzimi 100 pikë, i cili konvertohet në notë në procesverbalin përfundimtar. Bazuar në rregulloret e mësipërme, si dhe nga verifikimi i syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve konsiston:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivizimi në seminar, Detyra, projekte, etj.: 10%-20% të vlerësimit total;</li> <li>• Provim i ndërmjetëm: 20% të vlerësimit total;</li> <li>• Provimit përfundimtar: 60-70% të vlerësimit total.</li> </ul> <p>Studentit i rekomandohet të ndjekë leksionet së paku në masën 50%. Seminaret janë të detyrueshme për tu frekuentuar në masën 80%, ndërsa punët e laboratorit në masën 100% (me të drejtë shlyerje).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe</p>	<p>Referuar RVB, rregullores së programit të studimit, rregullores së Departamentit të Financës dhe vizitës në Institucion, GVJ konkludon që studentët informohen mbi kriteret dhe</p>



<p>diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>procedurat e diplomimit për këtë program studimi. Procedura e përmbylljes së studimeve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Me mbrojtje punim diplome.</i> Rregullorja Departamentit të Financës ka të përcaktuar kriterin e notës mesatare (8 e lart) që studenti të ketë mundësi për përmbylljen e studimeve me punim diplome. Tema e diplomës duhet të përkojë me fushat e kërkimit të departamentit. Studentëve u ofrohet një listë me fushat e ekspertizës dhe temat orientuese për diplomë.</li> <li>- <i>Me provim diplome.</i> Ky provim diplome bazohet në një bankë pyetjesh nga Lëndë Kategorizuese të zhvilluara gjatë tre viteve të programit të studimit. Banka e pyetjeve përgatitet nga personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi .</li> </ul> <p>Punimi/ provimi i diplomës vlerësohen me notë, nga komisioni i ngritur nga njësia bazë. Referuar takimit me studentët gjatë vizitës në Institucion, ata ishin të mirëinformuar për mënyrën dhe procedurat e diplomimit, gjatë viteve të studimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_4_Rregullore e programit të studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_28_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese</i></li> <li>▪ <i>An. 2_10_Kërkesat për përgatitjen e diplomës.</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_28_1_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP)</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, të marrë gjatë vizitës në Institucion, si dhe në faqen web të KUQ, GVJ konstaton se Institucioni realizon aktivitete si: fushatë sensibilizuese me maturan të në shkolla publike dhe private, trajnime me nxënës të gjimnazeve, Open Day, panairi “Work and Study”, afishim të informacionit në mjediset e KUQ, komunikim në rrjetet sociale, për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi të gjitha programet e studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë.pdf.pdf</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_35_Raport mbi panairin e punës</i></li> <li>▪ <i>An. 1_27_Rreth marketingut të Kolegjit Universitar “Qiriazhi</i></li> <li>▪ <i>An. 1_26_Fletëpalosje e Kolegjit Universitar Qiriazhi</i></li> <li>▪ <i><a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></i></li> </ul>



<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konstaton:</i>			
	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre, transferimit të studimeve si dhe njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh.</i></li> <li>- <i>Institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit, dhe përmblyljes së tyre me punim diplome apo provim diplomimi.</i></li> <li>- <i>Institucioni realizon një numër të lartë aktivitetesh duke informuar përpara fillimit të çdo viti akademik të interesuarit dhe studentët e ardhshëm për programet e studimit.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Referuar RVB, vizitës në Institucion, si dhe faqes web të KUQ, GVJ konkludon se studentët e programit të studimit Bachelor në Financë informohen në javën e parë të fillimit të vitit të parë akademik -java informuese- nga pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi, si dhe sekretaria mësimore e KUQ për të gjitha detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe elementët ndihmës në funksion të këtij procesi, si dhe i sqaron për çdo pyetje apo paqartësi që mund të kenë studentët. Informacion ofrohet edhe në faqen web të KUQ si edhe në rrjetet sociale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An_1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> <li>▪ <i><a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></i></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për	<p>Studentët e këtij program studimi marrin informacion më të detajuar për të gjithë elementët lidhur me modulet e kurrikulës së programit, gjatë prezantimit të javës së parë të mësimimit nga pedagogët e lëndëve që do të zhvillohen në këtë program studimi. Informacion të detajuar studentët mund të gjejnë edhe</p>



<p>lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>në: sekretarinë mësimore, faqen web të KUQ, afishimet në ambientet e Institucionit, si edhe në rrjetet sociale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> <li>▪ <a href="https://qiriaz.edu.al/">https://qiriaz.edu.al/</a></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Referuar RVB, dokumentacionit shoqërues dhe veçanërisht nga takimi me përfaqësuesit e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Pranim Këshillim Karriere (ZMJPKK) gjatë vizitës në Institucion, rezultoi se kjo strukturë kujdeset kryesisht për informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe mundësitë për internship.</p> <p>Gjithashtu kjo zyrë ofron trajnime për studentë në përgatitjen për të aplikuar për punësim, si dhe organizon evente të ndryshme në funksion të punësimit. Panairi “Work and Study”, Open Day, janë aktivitete që ndikojnë pozitivisht në punësimin e studentëve. Gjatë vizitës në Institucion dhe veçanërisht gjatë takimit me studentë, doli në pah se informacion për punësim u ofrohej edhe nga pedagogë të angazhuar në këtë program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_25_Lista e trajnimeve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit të Financës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstaton se, pedagogët e departamentit të Financës të angazhuar në këtë program studimi, në javën e parë informuese të fillimit të studimeve, në orën e parë të fillimit të lëndës së tyre, sekretaria mësimore, si dhe në mënyrë më të dedikuar Koordinatori për programin e studimit, luajnë një rol kyç në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Faqja web e KUQ si dhe rrjetet sociale luajnë gjithashtu një rol thelbësor në ofrimin dhe përditësimin e informacionit në lidhje me elementë të rëndësishëm të procesit mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të</i></li> <li>▪ <a href="https://qiriaz.edu.al/">https://qiriaz.edu.al/</a></li> </ul>

<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet faqes zyrtare të KUQ, komunikimi në klasat e krijuara në Google Classroom, rrjete sociale dhe nëpërmjet adresave të emailit studentët e këtij programi studimi mund të informohen edhe në distancë lidhur me strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar sipas lëndëve që kanë frekuentuar, orarin e provimeve, etj, si dhe të informohen lidhur me infrastrukturën dhe aktivitete të tjera të organizuara nga Kolegji Universitar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Studentët informohen në fillim të vitit të parë akademik, si dhe gjatë gjithë periudhës së studimeve për të gjithë detajet që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe elementët ndihmës në funksion të tij.</i></li> <li>- <i>Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Pranim Këshillim Karriere, ofron informacion për mundësitë për internship dhe punësim të studentëve.</i></li> </ul> <p><i>Studentët janë të përditësuar dhe kanë si akses në informacionin në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën, logjistikën dhe elementë të tjerë mbështetës të tij.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Njësitë bazë dhe Sekretaria Mësimore janë njësitë që kujdesen për mbajtjen e të dhënave dhe përpunimin statistikor vjetor për numrin e studentëve e të diplomuarve, në të gjithë programet e studimit të ofruar nga Institucioni.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të</p>	<p>Sekretaria mësimore e KUQ mbledh, regjistron dhe përditëson të dhënat lidhur me studentët e regjistruar në këtë program studimi, për ecurinë mësimore të tyre gjatë ciklit të studimeve</p>



<p>regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>dhe diplomimin e tyre. Regjistrat në sekretari (themeltar, i arritjeve akademike) janë të formatuar sipas standardeve shtetërore. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për numrin e regjistruar të studentëve në këtë program studimi janë:</p> <table border="1" data-bbox="616 566 1326 869"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr i të regjistruarve</th> <th>Nr i të diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>10</td> <td></td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>6</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>6</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>8</td> <td>13</td> </tr> </tbody> </table> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 3.Studentë të diplomuar dhe nota mesatare ne hyrje dalje e tyre</li> <li>▪ An. 2_9 Numri studentëve të regjistruar në vite në FE</li> </ul>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të diplomuarve	2019-2020	10		2020-2021	6	8	2021-2022	6	6	2022-2023	8	13
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të diplomuarve														
2019-2020	10															
2020-2021	6	8														
2021-2022	6	6														
2022-2023	8	13														
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstaton se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të KUQ. Pranë sekretarisë mësimore informacioni ruhet në formatin letër (versioni hard copy) dhe në versionin elektronik (soft copy në excel). Të dy mënyrat e ruajtjes lehtësojnë kontrollin e të dhënave nga personat e autorizuar dhe japin siguri lidhur me respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësit e KUQ që merren me përpunimin e të dhënave personale bazohen në kriteret e përcaktuara në rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ An. 1_1 Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021</li> <li>▪ An. 1_10 Rregullore e sekretarisë mësimore</li> </ul>															
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njëjësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm</p>	<p>Referuar RVB, njësitë përgjegjëse për menaxhimin e informacionit janë Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Administrimit Akademik, Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë. Institucioni ka hartuar rregulloret përkatëse për këto njësi, por GVJ bazuar në parregullsitë e gjetura në Zyrën e Sekretarisë Mësimore, konkludon që ky kontroll periodik nuk është realizuar konform me rregulloret përkatëse.</p>															



<p>të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1 Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021</i></li> <li>▪ <i>An. 1_10 Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> <li>▪ <i>10.Rregullore e NJSBC</i></li> </ul>												
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Financës analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve për secilin program studimi. Ky informacion është pjesë e analizës së veprimtarisë së departamentit për vitin akademik, e cila mbyllet me problematikat dhe shoqërohet me rekomandime për përmirësime.</p> <table border="1" data-bbox="608 920 1321 1167"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Mesatarja në hyrje</th> <th>Mesatarja në dalje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>7,3</td> <td>7,1</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>7,6</td> <td>7,4</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>7,4</td> <td>6,7</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjithashtu, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Pranim Këshillim Karriere, mbledh informacion në lidhje me punësimin e të diplomuarve dhe ia kalon këtë informacion njësisë bazë, përgjegjës për këtë program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>3.Studentë të diplomuar dhe nota mesatare ne hyrje dalje e tyre</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022</i></li> <li>▪ <i>11. Raporti ALUMNI (analizë) për gjurmimin e studentëve</i></li> </ul>	Viti akademik	Mesatarja në hyrje	Mesatarja në dalje	2020-2021	7,3	7,1	2021-2022	7,6	7,4	2022-2023	7,4	6,7
Viti akademik	Mesatarja në hyrje	Mesatarja në dalje											
2020-2021	7,3	7,1											
2021-2022	7,6	7,4											
2022-2023	7,4	6,7											
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konstaton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>KUQ mban dhe disponon statistika mbi numrin e studentëve të regjistruar, studentëve gjithsej dhe të diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit.</i></li> <li>- <i>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit, janë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke</i></li> </ul>												



	<p><i>siguruar respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</i></p> <p>- <i>Departamenti i Financës përgjegjës për këtë program studimi analizon në mënyrë periodike të dhënat mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve dhe punësimin e tyre.</i></p> <p><b><i>GVJ sugjeron që në Sekretarinë Mësimore të ushtrohen kontrole periodikë të brendshëm, për shkak të parregullsive të evidentuara gjatë vizitës në Institucion.</i></b></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion, rezulton se KUQ bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë nr 80/2015, Statutin (neni 9, 48, 51) dhe Rregulloren e KUQ u mundëson studentëve përfaqësimin në organet e KUQ, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Ata marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së KUQ, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Gjithashtu rregullorja e Departamentit të Financës (neni 65) u mundëson studentëve të shprehin mendime dhe propozime për programe, rregullore për veprimtari mësimore, zhvillimin e aktivitetetve të ndryshme, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1_ Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021;</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3_ Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi 2022</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_ Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të	GVJ konstaton se aktualisht KUQ përdor sistemin e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve/moduleve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve realizohet





<p>tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>nga zyra e NJSBC e cila përgatit raport analitik për çdo njësi bazë dhe ua paraqet këtë të fundit organeve drejtuese. Studentët duke pasur përfaqësim në organet e Kolegjit (sipas legjislacionit në fuqi) përfshihen në procese të ndryshme siç janë këshillimi mbi programin e studimit, kurrikulën, vlerësimin e procesit dhe stafit akademik, si dhe në aktivitete të tjera akademike dhe më gjerë, në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Ata janë edhe pjesë e procesit të vlerësimit të brendshëm të Institucionit dhe Programeve që ofrohen pasi pjesë e GVB-ve është gjithmonë një përfaqësues i studentëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazit 2021;</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazit 2022</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe veçanërisht Departamenti i Financës, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve të studentëve për kurrikulën dhe stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi. Gjithashtu në përbërje të NJSBC-së është një student, i cili sjell zërin e studentëve më pranë grupit të punës që bën vlerësimin e cilësisë së këtij program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_5_2_Politikat e Vlerësimit të Brendshëm</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_1_Pyetësor për studentët që diplomohen</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/</p>	<p>Departamenti i Financës, përgjegjës për këtë program studimi ka të parashikuar në rregulloren e tij (neni 32) garantimin e barazisë dhe ndershmërisë në procesin e vlerësimit dhe kontrollin e dijeve, (neni 35) të drejtën e studentit për të ankimuar për shkelje të rregullave të provimit dhe vlerësimit duke adresuar kërkesën e tij me shkrim pranë Drejtuesit të Njesisë Bazë. Drejtuesi i Njesisë Bazë ia kalon ankesën pedagogut të lëndës, i cili është i detyruar të kthejë përgjigje me shkrim brenda 24 orëve. Gjatë vizitës në Institucion, studentët pohuan se ata kishin mundësi të shikonin provimin, pikët dhe vlerësimin dhe të ankimonin vlerësimin sipas rregullores së Departamentit të Financës.</p>




njesisë/pedagogut përgjegjës.	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>Vizita në institucion-takimi me studentët;</i></li> </ul>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Statuti dhe Rregulloret e Institucionit u mundësojnë studentëve përfaqësimin në organet e KUQ, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.</i></li> <li>- <i>Studentët përfshihen në këshillim, sugjerim për rishikim dhe përmirësim të programit të studimit kryesisht bazuar në përpunimin e të dhënave të pyetësorëve nga NJSBC, si dhe këshillave studentorë.</i></li> <li>- <i>Studentët kanë të drejtën e ankimit për shkelje të rregullave gjatë zhvillimit të provimit dhe për vlerësimin në provim.</i></li> </ul>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Në Statutin dhe rregulloret e KUQ, si dhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedurat dhe njësitë/strukturat e dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore; Koordinatori i programit të studimit; Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë, si dhe Departamenti i Financës, përgjegjës për këtë program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1_Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazi 2021;</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazi 2022</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>An. 1_10_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të</i></li> <li>▪ <i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë</i></li> </ul>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Financës, që është edhe njësi bazë që mbulon këtë program studimi është përgjegjës për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve nëpërmjet njërive të sipërpërmendura, por edhe stafit të saj akademik. I gjithë stafi i njësisë bazë, por në veçanti Koordinatori i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi.</p> <p>Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë e cila administron rrjetet sociale krijon një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, dhe ofron informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_2_Rregullore e Departamentit të Financës</i></li> <li>▪ <i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstaton se shërbimi i këshillimit të karrierës për studentët e KUQ ofrohet nga Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë. Specialistët e kësaj zyre këshillojnë studentët për të gjitha hallkat në përgatitjen për tregun e punës. Nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme si trajnime të ndryshme, panairin “Work and Study”, Guest lectures, Open Day, evente të klubeve studentorë, përdorimin e faqes web të KUQ, etj, synohet të rritet pjesëmarrja aktive, të promovohen studentët, si dhe të rriten mundësitë e punësimit të tyre. Kjo zyrë u ofron studentëve mundësi për të realizuar praktika profesionale brenda vendit, dhe në disa raste edhe jashtë vendit. Ndërkohë studentëve u ofrohet edhe mundësia për punësim sezonal jashtë vendit, praktikë kjo që ndihmon studentët në përballimin e kostos së studimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_9_Rregullore e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë</i></li> <li>▪ <i>An. 1_8_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit, brenda dhe jashtë vendi</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_35_Raport mbi panairin e punës</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_25_Lista e trajnimeve</i></li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_19 Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit të Financës</i></li> </ul>												
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë, ndjek studentët pas diplomimit në funksion të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbjajtjes dhe përpunimit të të dhënave në lidhje me shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve;</li> </ul> <table border="1" data-bbox="619 566 1321 813"> <thead> <tr> <th><i>Viti</i></th> <th><i>Të diplomuar</i></th> <th><i>Të pënuensuar në profesion</i></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>2019-2020</i></td> <td>10</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td><i>2020-2021</i></td> <td>6</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td><i>2021-2022</i></td> <td>6</td> <td>Nuk ka informacion</td> </tr> </tbody> </table> <p>Krijimi i rrjetit ALUMNI, për të ndikuar në rritjen e cilësisë së programit të studimit për të ardhmen. Të dhënat statistikore të përpunuara nga kjo zyrë i dërgohen Përgjegjësit të Departamentit të Financës dhe Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, të cilat konsiderohen në analizën e punës vjetore të Fakultetit dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi, dhe programeve të studimit që ofrohen nga ky fakultet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>11. Raporti ALUMNI (analizë) për gjurmimin e studentëve</i></li> <li>▪ <i>An. 2_16 Statistikë mbi diplomimin dhe punësimin në FE</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_19 Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022</i></li> </ul>	<i>Viti</i>	<i>Të diplomuar</i>	<i>Të pënuensuar në profesion</i>	<i>2019-2020</i>	10	6	<i>2020-2021</i>	6	4	<i>2021-2022</i>	6	Nuk ka informacion
<i>Viti</i>	<i>Të diplomuar</i>	<i>Të pënuensuar në profesion</i>											
<i>2019-2020</i>	10	6											
<i>2020-2021</i>	6	4											
<i>2021-2022</i>	6	Nuk ka informacion											
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni ka njësi/struktura të dedikuara në shërbim të studentëve si Sekretaria mësimore; Koordinatorin e programit të studimit; si dhe Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranim dhe Këshillim për Karrierë (ZMJPKK).</i></li> <li>- <i>Njësia bazë dhe kryesore që mbulon këtë program studimi është gjithashtu përgjegjëse për informim dhe shërbim ndaj studentëve.</i></li> </ul>												




	<p><i>Specialistët ZMJPKK-së u ofrojnë studentëve informacion dhe këshillim për procesin mësimor, praktika profesionale, si dhe orientim në tregun e punës.</i></p> <p><i>ZMJPKK ndjek studentët pas diplomimit, mbledh e përpunon të dhëna mbi cilësinë e punësimit të studentëve dhe ia dërgon Përgjegjësit të Departamentit të Financës dhe Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë. Ky informacion konsiderohet në analizën e punës vjetore të Fakultetit dhe në përmirësimin e cilësisë së këtij program studimi dhe programeve të studimit që ofrohen nga ky fakultet.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni ka në fokus të politikave dhe objektivave të tij zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit. KUQ harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të përmbushjes së misionit të tij. "Strategjia e Zhvillimit Strategjik Institucional të KUQ 2021-2026" ka si vizion: të shndërrohen në Kolegj lider, duke vendosur standarde të larta në mësimdhënie, kërkim shkencor, profesionalizëm dhe integritet. Në kuadër të udhëzuesit në nivel institucional, njësitë bazë dhe strukturat e tjera hartojnë planet e punës për përmbushjen e objektivave të vëna.

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_2 Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"</i></li> <li>▪ <i>An. 1_13 Udhëzues për kualifikimin e stafit akademik të KUQ;</i></li> <li>▪ <i>An. 1_5_1 Manuali i Cilësisë së KUQ</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë KUQ mbështetur në rregulloren për këtë njësi synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga KUQ, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit/ vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Institucioni bën monitorim të vazhdueshëm dhe vlerësim periodik të procesit mësimor për personelin akademik, kryesisht nëpërmjet bashkëpunimit me Departamentin e Financës. NJSBC-ja harton një plan kalendar të punës së saj ku mekanizmat kryesorë që përdoren janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësor për studentët (për stafin akademik dhe për lëndët e kurrikulës së programit)</li> <li>- Pyetësor për stafin akademik</li> <li>- Kontroll periodik mujor në auditor gjatë procesit mësimor</li> </ul> <p>Në fund të çdo viti akademik, bazuar edhe në raportet analitike për çdo njësi kryesore që përgatit zyra e NJSBC-së, bëhet analiza e ecurisë së punës vjetore të Fakultetit të Ekonomisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 1_5_2 Politikat e Vlerësimit të Brendshëm</i></li> <li>▪ <i>Politikat e e Njesise te sigurimit te brendshem te cilesise</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20 Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_32 Pyetësor për Pedagogun</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_38 Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se pjesë e NJSBC-së të përbërë nga 5 anëtarë, është edhe një përfaqësues i studentëve. Gjithashtu edhe GVB gjithmonë ka në përbërjen e tij një student nga programi që akreditohet. Ndërkohë mbështetur në rregulloren e NJSBC-së studentët përfshihen rregullisht në vlerësimin e personelit akademik dhe programit të studimit nëpërmjet</p>




<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>plotësimi të pyetësorit për student. Studenti ka mundësi që të japë mendimin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik, si dhe për përmbajtjen e lëndës. Ky feedback i studentëve ndikon në përmirësimin e këtij program studimi, si në funksion të mësimdhënies, ashtu edhe të kurrikulës. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Departamentin e Financës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14_Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në KUQ, GVJ konkludon se NJSBC si strukturë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Harton çdo vit raportin vjetor të vetvlerësimit. Ky është një raport analitik për çdo njësi kryesore dhe ia dërgon atë drejtuesve të njësisë kryesore, si dhe Rektoratit.</li> <li>- Drejtuesit e njësisë kryesore i dërgojnë në mënyrë konfidenciale rezultatet individuale çdo anëtari të stafit akademik të njësisë kryesore.</li> <li>- Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, në bashkëpunim me Përgjegjësit e Departamenteve bëjnë një analizë vjetore ku merren vendimet përkatëse në funksion të rritjes së cilësisë së programeve të studimit që ofrohen.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_32_Pyetësor për Pedagogun</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_38_Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14_Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për</p>	<p>Referuar vizitës në Institucion, në takimin me personelin akademik të këtij program studimi GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për personelin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për</p>



përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	të botuar artikuj në revista me faktor të lartë impakti- Scopus, mbështetje për trajnime jashtë vendit).		
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_26_Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi</i></li> <li>▪ <i>An. 1_16_1 Miratim i fondit, për punën shkencore viti akademik</i></li> <li>▪ <i>Vizita në Institucion</i></li> </ul>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni harton periodikisht udhëzues në nivel institucional në shërbim të përmbushjes së misionit dhe vizionit të Kolegjit.</i></li> <li>- <i>Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, veçanërisht NJSBC dhe Fakulteti i Ekonomisë, vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik, raportojnë në instancat përkatëse sipas rregullores së KUQ, gjë që reflektohet në vendimmarrjet e mëtejshme në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</i></li> <li>- <i>Studentët përfshihen në mënyrë aktive në procesin e vlerësimit të cilësisë, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve, pjesëmarrjes në komisionet e përhershme, si edhe këshillit studentor.</i></li> </ul> <p><i>Institucioni është i angazhuar në nxitjen e personelit akademik në funksion të mësimdhënies dhe kualifikimit shkencor.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me	Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se statuti i KUQ (neni 51) përcakton që Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në rregulloren e KUQ (neni 89) është përcaktuar se NJSBC është struktura e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson



<p>parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Ky komision është ngritur dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë së Institucionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1 Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021;</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3 Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazhi 2022</i></li> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Anëtarët e NJSBC-së përzgjidhen nga Rektori pas konsultimit me drejtuesit e njësive nga vijnë kandidaturat. Miratimi i anëtarëve të NJSBC-së dhe i kryetarit të tij bëhet nga Senati Akademik. Kjo strukturë ka pesë anëtarë, nga të cilët një është përfaqësues i studentëve. KUQ ka hartuar planin për zhvillimin strategjik të institucionit ku evidentohet qartësisht që Kolegji është i përkushtuar për të siguruar cilësi në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, duke fuqizuar të gjithë strukturat brenda kolegjit, si dhe duke shtuar bashkëpunimin ndërmjet tyre. Fokusi i Institucionit për të bërë këto struktura sa më efektive doli në pah edhe gjatë takimeve të GVJ-së gjatë vizitës në KUQ.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_1 Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021;</i></li> <li>▪ <i>An. 1_2 Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit Universitar "Qiriazhi"</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në Institucion, GVJ konstaton se statuti i KUQ (neni 52) përcakton që Institucioni harton politika dhe procedura në përputhje me Kodin e Cilësisë. KUQ i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit të Institucionit, si dhe të çdo program studimi që ofron, pranë ASCAL. Programi i studimit Bachelor në Financë, është duke u vlerësuar për herë të dytë nga ASCAL, pas riorganizimit të tij në vitin 2020.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_40 Vendimi i Bordit të Administrimit për akreditimin e Programit të ciklit të parë BACHFI</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_39 Urdhër i MASR Për riorganizimin e programit të ciklit të parë BACHFI</i></li> <li>▪ <i>An. 1_1 Statuti i Kolegjit Universitar Qiriazhi 2021;</i></li> </ul>




<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ referuar dokumentet e dorëzuara dhe vizitës në Institucion, konkludon që NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor si dhe analizës kërkimore shkencore në këtë Institucion. Raportet e përgatitura iu dërgohen strukturave drejtuese, rektoratit dhe njësive kryesore në këtë Institucion.</p> <p>Strukturat drejtuese dhe në vecanti Dekani i Fakultetit të Ekonomisë në bashkëpunim me Përgjegjës të Departamentit të Financës përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 1_5_2 Politikat e Vlerësimit të Brendshëm</i></li> </ul>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni harton politika dhe procedura në funksion të sigurimit të cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore.</i></li> <li>- <i>KUQ ka hartuar planin për zhvillimin strategjik të Institucionit ku evidentohet përkushtimi ndaj cilësisë.</i></li> <li>- <i>NJSBC përgatit raporte me tregues sasior dhe cilësor, dhe ua dërgon strukturave përkatëse, të cilat marrin vendime në funksion të përmirësimit të cilësisë.</i></li> </ul>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dërguar dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ-ja konstaton se në KUQ aktiviteti i NJSBC-së ka një sistem raportimi vjetor dhe në formën e një raporti analize mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve dhe të stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</p>



<p>shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Aktualisht pyetëtori është uniform për të gjitha programet e studimit që ofron KUQ dhe pyetësorët plotësohen fizikisht. Vlerësimet e NJSBC raportohen në strukturat drejtuese të përcaktuara në rregulloren e njësisë. Ato janë pjesë e informacionit të paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit të institucionit si dhe përdoren nga njësia kryesore në bashkëpunim me njësinë bazë në analizën vjetore përkatëse. Në këtë raport analizohet ecuria e procesit mësimor, kërkimor shkencor dhe elementë të tjerë të përcaktuar në rregulloren e kësaj njësie, në rang njësie kryesore, njësisë bazë si edhe për program studimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 1_5_2_Politikat e Vlerësimit të Brendshëm</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_32_Pyetësor për Pedagogun</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_38_Instrumente të Monitorimit të Cilësisë</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14_Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022.;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezulton se në mbledhjen e fakultetit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, pyetësorët për stafin akademik, si dhe kontrollet e realizuara nga NJSBC. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë në mbledhjen e fakultetit, që i dërgohet Rektoratit. Në këtë raport vjetor të vetëvlerësimit të Fakultetit të Ekonomisë, përcaktohen qartë objektivat kryesore në lidhje me procesin mësimor dhe kualifikimin shkencor. Ky raport përmban informacion të gjerë sasior dhe cilësor lidhur me ecurinë e programeve dhe procesin mësimor, vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të cilësisë të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor, si dhe rekomandime e sugjerime për të ardhmen.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 2_14_Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të</p>	<p>Në takimet me drejtuesit e njësisë kryesore dhe njësisë bazë që mbulon këtë program studimi, GVJ-ja konstaton se përdoren disa procedura periodike për vlerësimin e realizimit, të</p>




<p>studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit të studimit në nivel Institucioni, Fakulteti dhe Departamenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- NJSBC përpunon pyetësorët e studentëve duke bërë një raportim për stafin akademik dhe kurrikulën e programit të studimit;</li> <li>- NJSBC përpunon pyetësorët e stafit akademik në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies në këtë program studimi, si dhe rritjes së nivelit të kërkimit shkencor.</li> <li>- Dekani i Fakultetit në bashkëpunim me Drejtuesin e Departamentit të Financës bazuar në raportin e NJSBC-së realizon analizën vjetore të veprimtarisë së fakultetit, ku merren vendime për ndryshime në funksion të përmirësimit të cilësisë, të programeve që ofrohen.</li> </ul> <p>Gjithashtu në nivel Institucioni bëhen vëzhgime periodike mujore të zhvillimit të mësimin në auditor.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_32_Pyetësor për Pedagogun</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_38_Instrumente të Monitorimit të Cilësisë</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14_Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e</p>	<p>KUQ në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizmat e mëposhtëm kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësor për studentët (për stafin akademik dhe për lëndët/modulet e kurrikulës së programit);</li> <li>- Pyetësor për stafin akademik;</li> <li>- Pyetësor për studentët që diplomohen;</li> <li>- Pyetësor për gjurmimin e studentëve;</li> <li>- Pyetësor për Klubet studentore;</li> </ul> <p>Instrumentet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta që përdoren nga NJSBC, vjelin informacion të vyer për rritur cilësinë e këtij program studimi. Feedback-u vjen në trajtën e përmirësimit të mësimdhënies, përfshirjes së metodave inovative, përmirësimit të kurrikulës së programit si dhe përafrimin e këtij programi me nevojat që ka tregu për profesionistë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_Pyetësorët e studentëve</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_32_Pyetësor për Pedagogun</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_38_Instrumente të Monitorimit të Cilësisë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_1 Pyetësor për studentët që diplomohen</i></li> </ul>

dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_2 Pyetësor për gjurmimin e studentëve KUQ</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_20_3 Pyetësor për Klubet studentore në KUQ</i></li> </ul>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>KUQ ka një sistem raportimi duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies, si dhe kurrikulën e çdo programi studimi.</i></li> <li>- <i>Në nivel njësie kryesore bëhen analiza vjetore të punës mësimore dhe kërkimore bazuar në përpunimin e pyetësorëve të studentëve, pyetësorëve të stafit akademik, kontrolleve të rastësishme, duke nxjerrë në pah arritjet dhe rekomandimet për të ardhmen.</i></li> <li>- <i>Institucioni në kuadër të vlerësimit të cilësisë përdor një sërë metodash të tërthorta në funksion të përmirësimit të këtij program studimi.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë konform legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Këto struktura janë ngritur në nivel Institucioni, Njësie Kryesore dhe Njësie Bazë. Struktura më e aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe veçanërisht me njësinë kryesore dhe njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e cilësisë së KUQ, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.</p> <p>Strukturat e sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Referuar rregullores së KUQ në këto struktura përfshihen personel akademik efektiv, studentë si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë në aktivitete të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e KUQ, në</p>




	<p>NJSBC, si dhe në hartimin e RVB për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 1_5_2 Politikat e Vlerësimit të Brendshëm</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_38 Instrumenta të Monitorimit të Cilësisë</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar informacionit të paraqitur në RVB, në statutin dhe rregulloren e KUQ, janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. Në rregulloret e NJSBC, Fakultetit të Ekonomisë dhe të Departamentit të Financës janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse në funksion të sigurimit të cilësisë. Ndërkohë në çdo grup pune të ngritur në kuadër të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm përcaktohen detyrat për çdo anëtar të grupit të punës. Detyrat janë të përcaktuara qartë edhe për studentët kur këta janë të përfaqësuar në këto grupe vlerësimi. GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion që studentit të angazhuar në GVB për këtë program studimi, i ishin përcaktuar detyrat përkatëse që do të kishte në funksion të përgatitjes së RVB.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 1_3 Rregullore e Kolegjit Universitar Qiriazzi 2022</i></li> <li>▪ <i>An. 2_3 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></li> <li>▪ <i>Aneks. 3_2 Rregullore e Departamentit të Financës.</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>KUQ ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka për detyrë monitorimin në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë janë edhe Departamenti i Financës dhe Fakulteti i Ekonomisë, si njësi bazë dhe kryesore që ofrojnë këtë program studimi. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit, si staf drejtues, Koordinatori i programit të studimit, janë personeli akademik i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë. Ndërkohë pjesë e këtij vlerësimi janë edhe personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, si pjesë aktive e analizës vjetore të departamentit dhe komenteve e sugjerimeve në funksion të përmirësimit të kurrikulës. Në vlerësimin e brendshëm të këtij program studimi janë angazhuar në GVB pesë anëtarë: katër personel akademik dhe një student.</p>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>RVB</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Referuar RVB si dhe informacionit të vjelë gjatë takimit me stafin drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi GVJ konstaton se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Përzgjedhja e anëtarëve të grupeve të vlerësimit të brendshëm bëhet me vendim të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë, pas propozimit të bërë nga Drejtuesi i Departamentit të Financës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Vizita në Institucion;</i></li> <li>▪ <i>RVB;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në funksion të rritjes së cilësisë janë lidhur një sërë marrveshesh në nivel Institucioni. Këto marrveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, mundësojnë organizmin e aktiviteteve të ndryshme si trajnime dhe workshop-e, leksione të hapura, organizimin e panairit të punës “work and study”, future business ideas, open day; etj. Gjithashtu mundësojnë realizimin e praktikave profesionale për studentë, si dhe shpesh luajnë rol aktiv në punësimin e studentëve.</p> <p><b><u>GVJ sugjeron</u> që Departamenti i Financës, duhet të realizojë aktivitete me Institucione publike dhe private me të cilat ka marrveshje bashkëpunimi, të tipit “Tavolinë e rrumbullakët”, “Workshop”, me qëllim që të marrë feedback-un e tyre në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit Bachelor në Financë.</b></p> <p>Departamenti i Financës realizon plotësimin e një pyetësori me rrjetin ALUMNI por ky pyetësor kryesisht konsiston në gjurmimin e studentëve për punësimin e tyre. Ndërkohë nga ky rrjet mund të tërhiqet një feedback shumë i mirë në lidhje me përmirësimin e cilësisë së kurrikulës së këtij program studimi. GVJ mendon që pyetësori duhet të jetë i fokusuar edhe në cilësinë e kurrikulës, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>Aneks_3_19_Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit të Financës</i></li> <li>▪ <i>11. Raporti ALUMNI (analizë) për gjurmimin e studentëve</i></li> </ul>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludoi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni ka ngritur strukturat që garantojnë sigurimin e cilësisë në nivel Institucioni, të cilat kanë në përbërje të tyre personel akademik dhe studentë.</i></li> <li>- <i>Përzgjedhja e anëtarëve të strukturave të vlerësimit të cilësisë bëhet në respekt të integritetit akademik, duke shmangur diskriminimin apo pabarazinë.</i></li> <li>- <i>Anëtarët e njërive të sigurimit të cilësisë kanë të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.</i></li> </ul> <p><i>GVJ sugjeron që pjesë aktive e procesit të vlerësimit të cilësisë të bëhen edhe bashkëpunëtorë të jashtëm të Institucionit-përfaqësues të institucioneve publike dhe private me të cilat Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi si dhe rrjeti ALUMNI.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</b>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, si dhe të marrë gjatë vizitës në KUQ, GVJ konstaton se kuadri rregullator i Institucionit parashikon publikimin në faqen Web të tij, të të gjitha veprimtarive (statute, rregullore) përfshirë edhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel Kolegji. Informacioni në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore përcillet nga NJSBC. Ndërkohë që njësia kryesore në bashkëpunim me njësinë bazë organizon analizën e punës vjetore të fakultetit që merr në konsideratë edhe raportin e NJSBC-së. Studentët informohen përmes njësisë bazë për problematikat që mund të shfaqen në lidhje me cilësinë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4_Rregullore e NJSBC</i></li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në KUQ, GVJ konstaton se raporti vjetor i vlerësimit të brendshëm i hartuar nga zyra e NJSBC-së përgatitet analitik për çdo njësi kryesore dhe i shpërndahet rektoratit si dhe drejtuesve të njësive kryesore dhe njësive bazë, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionit për të dhënat personale. Drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore diskutojnë individualisht me stafin akademik për konkluzionet e dala në lidhje me vlerësimin e secilit prej tyre. Nga vizita në Institucion si dhe nga konsultimi i faqes web të Insitucionit u konstatua se nuk ka publikim të rezultateve të vlerësimit për programet e studimit që ofrohen nga ky Institucion.</p> <p><i><b>GVJ sugjeron publikimin e një raporti të përgjithshëm të hartuar nga NJCBC të detajuar për çdo program studimi. Ky informacion do të ishte vlerë e shtuar dhe në kuadër të transparencës së Institucionit.</b></i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> <li>▪ <i>Vizita në Institucion; <a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë, përfshin në analizën e punës vjetore të departamentit edhe raportin e hartuar nga NJSBC, duke përcaktuar objektivat për të ardhmen për programet që ofrohen. Në analizën e punës vjetore të Fakultetit të Ekonomisë për vitin 2021-2022, objektivat e vendosura kryesisht lidhen me vërejtjet dhe sugjerimet e raportit të vlerësimit të jashtëm të bërë nga ASCAL.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <i>An. 1_4 Rregullore e NJSBC</i></li> <li>▪ <i>An. 2_14 Analiza vjetore e Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022;</i></li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin</p>	<p>Bazuar në informacionin e RVB-së dhe vizitën në KUQ, GVJ konstaton që Institucioni e ka fokusuar kryesisht monitorimin e cilësisë nëpërmjet evidentimit të problematikave nga NJSBC dhe Njësia Bazë. Bazuar në raportet e përgatitur nga NJSBC dhe analizës vjetore të departamentit të Financës, Departamenti i Financës harton një plan aktivitetesh që do të ndërmarrë në vitin akademik vijues, në kuadër të përmirësimit në vijim të cilësisë së programit të studimit, dhe në përputhje</p>





<p>në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>me planin strategjik të këtij program studimi. Gjatë vizitës në institucion GVJ-së iu konfirmua nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse të programit të studimit, angazhimi për të përmirësuar programin e studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, duke u bazuar në problematikat e ndeshura si dhe ndryshimeve të kërkesave të tregut (mbështetur edhe në studimin e tregut të realizuar nga ky fakultet). Programi i studimit është riorganizuar në vitin 2018/2020 në përputhje me ndryshimet ligjore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Evidencë 77. Analiza vjetore Departamenti Financë Kontabilitet 2018-2022;</li> <li>▪ Aneks. 3_6_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit</li> <li>▪ Aneks. 3_5_ Plani strategjik i Programit të studimit Financë</li> <li>▪ An. 2_19_ Udhëzim mbi ndryshimet në syllabus, lëndë dhe programe</li> </ul>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke ju referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe informacionit të marrë në takimet gjatë vizitës në Institucion GVJ konstaton se veprimtaritë periodike me personelin dhe studentët në funksion të këtij kriteri lidhen me aktivitete informuese me studentë, publikime në faqen Web të KUQ, klasat e krijuara në Google Classroom, si dhe veçanërisht publikimet në rrjetet sociale me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të tyre në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vizita në Institucion; <a href="https://qiriazhi.edu.al/">https://qiriazhi.edu.al/</a></li> </ul>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konstatoi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti i hartuar nga NJSBC-ja respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</li> <li>- Njësia kryesore dhe njësia bazë realizojnë analizën e punës vjetore duke përcaktuar objektivat për të ardhmen për programet e studimit që ofron.</li> <li>- Drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore në sajë të problematikave të ndeshura dhe nevojave të tregut të punës angazhohen në funksion të përmirësimit në vijimësi të cilësisë së programit të studimit.</li> </ul> <p><i>GVJ sugjeron publikimin e një raporti të përgjithshëm të hartuar nga NJCBC të detajuar për çdo program studimi. Ky</i></p>



	<i>informacion do të ishte vlerë e shtuar dhe në kuadër të transparencës së Institucionit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Financë” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Qiriazi”.**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

- 1. Infrastruktura/ godina dhe mjedisi përreth.** Infrastruktura e godinës, mjediset e gjelbra që e rrethojnë dhe vendndodhja në një kampus universitar ofrojnë një ambjent shumë bashkëkohor për studentët e këtij programi studimi. Ambjentet janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të pajisur me mjete të teknologjisë së lartë, si dhe laboratorit i informatikës është i pajisur me programe dhe softëare të nevojshëm dhe të përshtatshme për aftësimin praktik dhe shkencor të studentëve.
- 2. Personeli akademik me eksperiencë.** Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, kombinon një staf akademik me shume eksperiencë akademike dhe profesionale, me një staf akademik të ri në moshë, të përkushtuar me shumë energji dhe i fokusuar në kërkim shkencor, duke krijuar premisa pozitive për këtë program studimi në afatmesëm dhe afatgjatë.
- 3. Përkushtimi ndaj studentëve, duke konsideruar dhe numrin e vogël të tyre.** Komunikimi dhe bashkëpunimi i ngushtë i studentëve të këtij program studimi, me personelin akademik të Departamentit të Financës doli në pah si gjatë takimit me stafin akademik, por vecanërisht në takimin me studentët e këtij program studimi.
- 4. Marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit dhe potenciali i tyre për kërkim-shkencor dhe punësim të studentëve duket se është i lartë në KUQ.** KUQ disponon një rrjet të gjerë kontaktesh dhe bashkëpunimi me aktorë të biznesit, shoqërisë civile, institucioneve publike dhe bashkëpunëtorësh të huaj. Ky rrjet është potencial për rritjen e mëtejshme akademike të stafit pedagogjik të angazhuar, sikurse edhe ofron mundësi punësimi për studentët e programit të studimit.

**Pika të dobta:**

- 1. Sekretaria mësimore.** Në sekretarinë mësimore ka mungesë të regjistrimit të diplomave të studentëve. Gjithashtu ka mospërputhje ndërmjet të dhënave në regjistrin fizik dhe atij që mbahej soft në excel. Aktualisht në sekretari ishte punësuar staf i ri, dhe puna aktuale është fokusuar në kontrollin e të gjithë dokumentacionit, në mënyrë që të bëhej rakordimi ndërmjet: të dhënave të procesverbalit, regjistrimit fizik dhe regjistrimit që mbahet në Excel (soft copy).
- 2. Mangësi në dokumentacionin e dosjeve të personelit akademik në Zyrën e Burimeve Njerëzore.** Gjatë vizitës në këtë zyrë u vu re mungesë sistemimi, në disa raste mungesë dokumentacioni si dhe përditësim i tij.

3. **Numri i titujve fizik dhe online në Bibliotekë.** Përditësimi i literaturës bazë bëhet rregullisht, ndërkohë që përditësimi i literaturës ndihmëse është i kufizuar, si fizikisht, ashtu edhe online.

#### **Rekomandime:**

1. Sekretaria mësimore të bëjë kontrollin që të rakordojnë të dhënat: procesverbal, regjistër fizik (të tre regjistrat bazuar në legjislacionin në fuqi) dhe regjistër elektronik, për këtë program studimi. Nga sekretaria në këtë institucion na u konfirmua që kjo është puna me të cilën po merren aktualisht. GVJ sugjeron që në Sekretarinë Mësimore të ushtrohen kontrole periodikë të brendshëm, për shkak të parregullsive të evidentuara gjatë vizitës në Institucion.  
Gjithashtu sugjerohet ngritja e një platforme elektronike të dedikuar për studentët, personelin akademik dhe jo-akademik. Duhet të mundësohet përdorimi i platformës për konsultimin e informacioneve apo dokumenteve si syllabuset e çdo lënde, materialet e ofruara nga pedagogët e lëndës, frekuentimi i studentëve, vlerësimi i vazhduar, lista e notave dhe krediteve.
2. Sugjerohet sistemim më i mirë i dosjeve të personelit akademik, të përditësimit të dokumentacionit, si dhe mbajtjen e tyre jo vetëm në formatin fizik por edhe në formatin on-line, që informacioni të jetë si transparent, ashtu edhe lehtësisht i aksesueshëm.
3. Sugjerohet shtimi i titujve fizikë të përditësuar në bibliotekë, veçanërisht për literaturën ndihmëse dhe për publikime shkencore. Sugjerohet dhe regjistrimin/ abonimin në biblioteka online ku studentët dhe stafi akademik të kenë akses. Kjo do të ndikojë në rritjen e cilësisë së këtij program studimi dhe të kërkimit shkencor të Institucionit.

#### **Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Finance" offered by the Institution of Higher Education "Qiriazi University College".**

#### **Strengths and affirmations**

1. **Infrastructure/ building and surrounding environment.**

The infrastructure of the building, the green surroundings that surround it and the location on a university campus offer a very contemporary environment for the students of this study program. The facilities are sufficient, suitable and equipped with high-tech tools, as well as the computer lab is equipped with programs and software necessary and suitable for the practical and scientific training of students.



**2. Academic personnel with experience.**

The academic staff engaged in this study program combines an academic staff with a lot of academic and professional experience, with a young academic staff, dedicated with a lot of energy and focused on scientific research, creating positive premises for this study program in medium and long term.

**3. Commitment to students, considering their small number.**

The communication and close cooperation of the students of this study program with the academic staff of the Department of Finance came to the fore during the meeting with the academic staff, but especially in the meeting with the students of this study program.

**4. Numerous cooperation agreements and their potential for scientific research and student employment seem to be high in KUQ.**

KUQ has a wide network of contacts and cooperation with business actors, civil society, public institutions and foreign collaborators. This network has the potential for the further academic growth of the engaged pedagogical staff, as well as providing employment opportunities for the students of the study program.

**Weaknesses**

**1. Teaching secretariat.**

In the teaching secretariat, there is a lack of the register of students' diplomas. There is also a discrepancy between the data in the physical register and the one that was kept in Excel. Currently, new staff was hired in the secretariat, and the current work is focused on the control of all the documentation, in order to make the reconciliation between: the data of the minutes, the physical register and the register kept in Excel (soft copy).

**2. Shortcomings in the documentation of academic staff files in the Human Resources Office.**

During the visit to this office, a lack of systematization was noticed, in some cases a lack of documentation and its updating.

**3. Number of physical and online titles in the Library.**

The core literature is regularly updated, while the supplementary literature is limited, both physically and online.



## **Recommendation**

1. The teaching secretariat should check to reconcile the data: minutes, physical register (all three registers based on the legislation in force) and electronic register, for this study program. The secretariat at this institution confirmed to us that this is the work they are currently dealing with. GVJ suggests that periodic internal checks be carried out in the Educational Secretariat, due to the irregularities identified during the visit to the Institution. It is also suggested to set up an electronic platform dedicated to students, academic and non-academic personnel. It should be possible to use the platform for consulting information or documents such as the syllabuses of each subject, materials provided by subject lecturers, student attendance, continuous assessment, list of grades and credits.
2. Better systematization of academic staff files, updating of documentation, as well as keeping them not only in physical format but also in online format, so that the information is both transparent and easily accessible, is suggested.
3. It is suggested to add up-to-date physical titles to the library, especially for supporting literature and scientific publications. It is also suggested to register/subscribe to online libraries where students and academic staff have access. This will affect the increase in the quality of this study program and the scientific research of the Institution.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				X
<b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR</b>				X
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				X
<b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>			X	
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				X
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				X

